

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Spring 3-2020

### Widows of civilian victims of war in Kosovo

Albonita Aliu

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)

---

#### Recommended Citation

Aliu, Albonita, "Widows of civilian victims of war in Kosovo" (2020). *Theses and Dissertations*. 1581.  
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1581>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



UBT College  
Faculty for Public Policy and Management

Albonita Aliu

**Widows of civilian victims of war in Kosovo**  
Master degree

March/2020  
Pristina



Universiteti për Biznes dhe Teknologji  
Fakulteti për Politika Publike dhe Menaxhim

Albonita Aliu

**Nënat vetushqyese/bashkëshortet/të vejat e viktimave civile të luftës në  
Kosovë**

Mentor:

Dr. Dritëro Arifi

Mars 2020/Prishtinë

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme  
për Shkallën Master

## Abstrakt

Drejtësia tranzicionale në vendet e dala nga lufta nënkupton edhe kompensime për të mbijetuarit e luftës, por jo të gjitha vendet ofrojnë këtë lloj të ndihmës. Kompensimi për kategoritë e viktimave civile të luftës së vitit 1998-1999 në Kosovë është mjeti më i zakonshëm i drejtësisë. Nënata vetushqyese/bashkëshortet e viktimave civile janë trashëgimtarët e para në radhë, me Rregulloret/Ligjet që mbulojnë kategoritë e dala nga lufta në Kosovë, për kompensimet e formës materiale. Ato, nënata vetushqyese/bashkëshortet e viktimave civile të luftës, paraqesin pjesën e marginalizuar të shoqërisë kosovare të pasluftës, pasi që ishin pjesë e dhunës strukturore të ushtruar nga pushteti serb. Do të trajtoj kategorinë e nënave vetushqyese/bashkëshorteve të viktimave civile të luftës me anë të teorisë feministe dhe teorisë feministe të paqes dhe konfliktit duke treguar se si ndikon gjinia në sigurinë e individëve të shtresave të marginalizuar në luftë dhe si siguria ekonomike e kësaj kategorie ndikoj në jetën e tyre të pasluftës. Këto gra ishin shtëpiake dhe të pashkolluara para luftës gjë që shpinte që ato të mos kishin bazë ekonomike për të ndërtuar jetën e tyre të pasluftës.

Pozita dhe roli i nënave vetushqyese/bashkëshorteve të viktimave civile të luftës nga viti 1999 deri më 2019 do të jetë pyetja hulumtuese e këtij punimi, duke identifikuar pastaj dallimet në mes të vejave/bashkëshorteve të viktimave civile dhe atyre të dëshmorëve me anë të teorisë feministe dhe teorisë së paqes dhe konfliktit, si bazë e këtij punimi.

Nevojat kryesore të nënave vetushqyese/bashkëshorteve të viktimave civile lidhen kryekëput me faktorin ekonomik dhe psiko-social. Ekzistojnë dallime në mes të kategorisë së viktimave civile dhe asaj të dëshmorëve të cilat i përfaqëson aktualisht ligji nr. 04/L-054, dallime të cilat duhet adresuar në institucionet që përfaqësojnë këto kategori.

Komponente të rëndësishme të drejtësisë tranzicionale, të tilla si duke kërkuar të vërtetën, ndjekjet, dëmshpërblimet dhe reformat institucionale, duhet të përpiqen të sigurojnë të drejtat e grave, ku do të përfshihej edhe mbështetja psiko-sociale, kujdesi shëndetësor, dhe rehabilitimi ekonomik.

***Fjalët kyçe:*** viktimat civile të luftës, të vejat, Kosovë, ligj, rregullore.

## Abstract

Transitional justice in war-torn countries implies compensation for war survivors, but not all countries offer this type of assistance. Compensation for the categories of civilian victims of the 1998-1999 war in Kosovo is the most common means of justice. Single mothers / wives of civilian victims are the first heirs, with Regulations / Laws covering categories derived from the war in Kosovo, for material form compensation. They, the single mothers / wives of civilian victims of war, represent the marginalized part of post-war Kosovo society as they were part of the structural violence perpetrated by the Serbian government. I will address the category of single mothers / wives of civilian victims of war through feminist theory and feminist theory of peace and conflict by showing how gender affects the safety of marginalized individuals in war and how the economic security of this category affects in their postwar life. These women were housewives and uneducated before the war, leading them to have no economic basis to build their post-war lives.

The position and role of single mothers / wives of civilian victims of war from 1999 to 2019 will be the research question of this paper, then identifying the differences between widows / wives of civilian victims and those of martyrs through feminist theory. and the theory of peace and conflict as the basis of this paper.

The main needs of single mothers / spouses of civilian victims are strongly related to economic and psychosocial factors. There are differences between the category of civilian victims and that of martyrs currently represented by law no. 04 / L-054, differences that need to be addressed in the institutions that represent these categories.

Important components of transitional justice, such as seeking truth, prosecutions, reparations and institutional reforms, should strive to secure women's rights, which would include psychosocial support, health care, and economic rehabilitation.

**Key words:** civilian victims of war, widows, Kosovo, law, regulation.

## Falënderime

*Ky studim është rezultat i një pune të gjatë, konsultime, kërkime në burime të ndryshme, i shkrimit, dhe i rishkrimit.*

*Unë do të dëshiroja të falënderoj të gjithë ata që më kanë dhënë një mbështetje dhe kontribut të çmuar për përfundimin e tij.*

*E falënderoj sinqerisht udhëheqësin (mentorin), Prof. Ass. Dr. Dritëro Arifi për udhëzimet dhe drejtimin e tij, i cili me sugjerimet profesionale ishte gjithmonë i gatshëm për ndihmë dhe drejtim të qartë, me udhëzime precize dhe mbështetje të pakursyer. Ishte kënaqësi, eksperiencë e veçantë dhe privilegj të punoja me Ju. Falënderoj gjithashtu të gjithë profesorët dhe stafin e UBT-së të cilët na kanë përkrahur dhe mbështetur gjatë këtyre viteve të studimeve.*

*Falënderim i veçantë për familjen time për përkrahjen e pakusht dhe motivimin!*

*Në realizimin e këtij punimi, përveç kontributit tim personal nuk mund të lë pa përmendur ndihmën e çmuar të një grupi miqsh e kolegësh.*

*Ky punim i dedikohet të gjitha nënave vetushqyese të viktimave civile të luftës së vitit 1999 në Kosovë.*

*Faleminderit të gjithëve!*

# PËRMBAJTJA

Abstrakt.....	iii
Abstract.....	iv
Falënderime .....	v
PËRMBAJTJA.....	vi
LISTA E TABELAVE .....	viii
FJALORI I TERMAVE.....	ix
1. HYRJE.....	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	3
2.1 Analiza teorike e problemit sipas këndvështrimit të autorëve më të njohur.....	3
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT.....	7
3.1 Formulimi i problemit dhe qëllimeve të hulumtimit .....	7
3.2 Objektivi kryesor dhe objektivat specifike të punimit .....	8
3.3 Pyetjet dhe hipotezat hulumtuese.....	9
3.4 Rëndësia dhe rezultatet e pritshme te punimit.....	10
3.5 Kufizimet e punimit.....	10
4. METODOLOGJIA .....	11
4.1 Metodologjia e aplikuar .....	11
4.1.1 Modelet e hulumtimit: Niveli mikro dhe Niveli makro. ....	11
4.1.2 Qasja historisë së jetës.....	11
4.1.3 Rastet e studimit – rast kritik dhe rast ekstrem ose unik .....	11
4.1.4Hulumtimi vlerësues .....	11
4.2 Metodat e aplikuara.....	12
5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE .....	14
5.1 Kronologji mbi luftën e viteve '98-'99 dhe pasojat e saj.....	14
5.2 Konceptet .....	15
5.3 Shtjellimi i problematikës sipas qasjes së autorit .....	16
5.3.1 Financimi i kategorive te dala nga lufta .....	17
5.4 Familja e Viktimës Civile – Lartësia e Pensioneve 1999-2019-Albonita Aliu .....	21
5.5 Mbledhja të dhënave nga Fondi për të Drejtën Humanitare .....	22

5.6 INTERVISTAT.....	25
5.6.1 Të dhënat statistikore nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale .....	25
5.6.2 ‘Lidhja e Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës në Kosovë - Komunalja e Prishtinës’ - Intervistë e me Rexhep Grabovci përfaqësues i shoqatës – Komunalja e Prishtinës .....	26
5.6.3 Intervistë – Ibadete Ahmeti nënë vetushqyese /bashkëshorte e viktimës civile të luftës – Prishtinë, 23 Dhjetor 2019 .....	28
5.6.4 Intervistë – Xhevrije Buzuku nënë vetushqyese/bashkëshorte e viktimave civile të luftës, Hallaç i Vogël-Lipjan, 27 Dhjetor 2019 .....	30
5.6.5 Intervistë – Vezire Shala nënë vetushqyese/bashkëshorte e viktimës civile të luftës – Banjë- Malishevë, 29 Dhjetor 2019 .....	31
5.6.6 Intervistë – Miradije Ramadani nënë vetushqyese/bashkëshorte e viktimës civile të luftës, Krushë e Madhe-Rahovec, 30 Dhjetor 2019 .....	32
5.6.7 Intervistë – Fevzije Gërxfhalu nënë vetushqyese/bashkëshorte e viktimës civile të luftës, Studime e Poshtme –Vushtrri, 3 Janar 2020.....	34
5.6.8 Intervistë – Nasibe Lluhani nënë vetushqyese/bashkëshorte e viktimave civile të luftës – Gjakovë, 4 Janar 2020 .....	35
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	37
7.1 Propozimet për politikat sociale në Kosovë – Nën timer vetushqyese të viktimave civile të luftës:..	41
REFERENCAT .....	42
BIBLIOGRAFIA.....	44



## **LISTA E TABELAVE**

Tabela 1. Ndryshimet në pensionet e kategorisë së viktimave civile të luftës 1999-2019

## **FJALORI I TERMAVE**

UNMIK – United Nations Mission in Kosovo (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)

MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

ZÇKL - Zyra për çështjet e kategorive të dala nga lufta

LIVCLK - Lidhja e Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës në Kosovë

UÇK – Ushtria Çlirimtare e Kosovës

FDH – Fondi për të Drejtën Humanitare

FDHK – Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë

LKK – Libër Kujtimi i Kosovës

TFPQ - Teoria Feministe e Paqes dhe Konfliktit

MN – Marrëdhënie Ndërkombëtare

## 1. HYRJE

Roli i gruas kosovare në periudhën e para luftës ka pasur një ngritje simbolike duke filluar kryesisht në vitet e gjashtëdhjeta e tutje, vite këto kur shoqëria kosovare ishte pjesë e ish-Jugosllavisë. Duke kërkuar kështu të drejtat e saj dhe duke u radhitur krah burrave në fushat më të rëndësishme të jetës së asokohshme, përfshirë këtu politikën, ekonominë dhe shoqërinë në përgjithësi. Por të drejtat e gruas nuk realizoheshin në plotni as në këtë periudhë.

Lufta e vitit 1998-1999 la gjurmë të pashlyeshme në historinë e re të Kosovës, bashkë me të solli edhe kategoritë e dala nga lufta. Me përfundimin e luftës, në Kosovë u vendos misioni i UNMIK-ut i cili me Rregulloren nr. 1999/1 të datës 25 Korrik 1999, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë vendos institucionet administrative. Fillimisht me këto kategori u morr Rregullorja e UNMIK-ut nr.2000/66 dhe nr. 2006/29, kështu me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/10 u be themelimi i Departamentit Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të datës 3 Mars 2000.

Pastaj i hapet rrugë Rezolutës së Kuvendit të Kosovës të nxjerrë të vitit 2003,për Luftën Çlirimtare të Popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi, duke pasuar kështu edhe miratimin e Ligjit Nr. 02/L-2 - ‘Ligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës’, të vitit 2006.

Në këtë mënyrë bëhet edhe kategorizimi i kësaj shtrese të shoqërisë së pasluftës në Kosovë. Kurse pas shpalljes së pavarësisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miraton ‘Ligj për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre’, Ligji Nr. 04/L-054. Në këtë analizë do të mundohem të shtjelloj pozitën e familjeve të viktimave civile të luftës së fundit, konkretisht, nënat vetushqyese (bashkëshortet) e viktimave civile si anëtare të familjes së ngushtë.

Gjithashtu do të krahasojë ndryshimet në Rregulloren e UNMIK-ut, Ligjin Nr. 02/L-2, Ligjin Nr. 04/L-054 dhe të gjitha ndryshimet eventuale gjatë periudhës 1999-2019, si dhe jap vërejtjet dhe sugjerimet gjatë grumbullimit të të dhënave.

Njëra nga çështjet kryesore që e bën dallimin më të madh ndërmjet kategorive të dala nga lufta është pensioni që ato e marrin si pjesë e kompensimit për dëmin në njerëz që ka shkaktuar lufta në Kosovë. Ky dallim më ka shtyrë që të punoj specifikisht me kategorinë e viktimave civile të luftës – nënat vetushqyese/bashkëshortet më konkretisht.

## 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

### 2.1 Analiza teorike e problemit sipas këndvështrimit të autorëve më të njohur

Ky punim do të bazohet mbi teoritë e feminizmit të cilat janë fushë relativisht e re në Marrëdhëniet Ndërkombëtare pasi i përkasin fundviteve të '80 dhe fillimin e viteve '90. Teoritë e feminizmit në Marrëdhëniet Ndërkombëtare njihen edhe si 'debati i tretë'. Fillet e feminizmit përkojnë me faktin se 'shpikësit' e teorive feministe kanë sfiduar disiplinën e Marrëdhënies Ndërkombëtare, duke e bërë atë të mendojë në riformulimin e teorive dhe përmirësimin e dijes mbi politikat ndërkombëtare, nëse do të përfshihej gjinia si kategori analize dhe nëse përvojat e grave do të bëheshin pjesë e studimit të kësaj tematike. Teoricienët e feminizmit mëtuan se vetëm duke përfshirë analizën e gjinisë në jemi në gjendje të kuptojmë ndikimin e sistemit shtetëror dhe të ekonomisë globale mbi jetën e gruas dhe burrit. Rryma feministe e MN rishqyrtoi në mënyrën kritike disa nga konceptet kyçe të fushës – koncepte, si sovraniteti, shteti dhe siguria (Tickner, Sjoberg, 2010).

Mungesa e dukshmërisë së grave si subjekte në politikën ndërkombëtare dhe ekonominë globale ka shtyrë teoricienët që të ndërmarrin masa. Padukshmëria e gruas dhe nënshtrimi i gjinisë së saj në teorinë dhe në praktikën e politikës ndërkombëtare. Këtu ata hulumtojnë shkaqet e kësaj situate dhe ndikimin e saj mbi strukturën dhe praktikën politikës globale (Tickner, Sjoberg, 2010). Teoricienët e feminizmit e përkufizojnë gjininë si një seri karakteristikash të ndërtuara nga shoqëria, që përshkruajnë se çfarë duhet të bëjnë gratë dhe burrat. Cilësi si fuqia, arsyetimi, pavarësia, mbrojtja dhe publikja që i referohen burrave, kurse dobësia, ndjeshmëria emocionale, familjare dhe privatja i referohen grave. Por që jo domosdoshmërisht këto karakteristika i takojnë njëres ose tjetres gjini dhe anasjelltas.

Feminizmi liberal dhe teorinë feministe të paqes dhe konfliktit janë baza e këtij punimi si pjesë rishikimit të literaturës. Për të shtjelluar tutje mbi analizën e gjinisë, sigurisë dhe politikat globale. Pastaj do të bazohet në ripërkufizimin e sigurisë dhe subjekteve të saj si dhe mbi mitin e mbrojtjes, duke e lidhur kështu me pasigurinë ekonomike, ku pastaj do të analizohet ndikimi i dallimeve gjinore në luftë – lidhja me sigurinë e individëve.

Feminizmi liberal sipas Tickner & Sjoberg tërheqë vëmendjen për pozicionin e nënshtuar të gruas në politikat globale. Hulumtimi i shkaqeve të këtij nënshtimi qëndron detyrimisht brenda kuadrit metodologjik të pozitivizmit. Feminizmi liberal sfidon përmbajtjen, por jo supozimet epistemologjike të marrëdhënieve ndërkombëtare tradicionale. Teoricienët e feminizmit liberal dokumentojnë aspekte të ndryshme të nënshtimit të gruas. Shembull i studimit, dhunimi i të drejtave të njeriut të vuajtura në mënyrë jo proporcionale nga gratë. Në këtë formë teoricienët e feminizmit e përdorin konceptin e gjinisë si kategori më vete analize, në mënyrë që t'i ndihmojë t'i kuptojnë këto pabarazi dhe pasojat e tyre për politikat globale (Tickner, Sjoberg, 2010, pp. 247-248)

*Teoria feministe e paqes dhe konfliktit* – Gjenealogjia e teorisë feministe vie si fenomen hibrid, TFPK ndërlidhet me një variacion të disiplinave dhe metodologjive. Është simptomatike për studimet gjinore dhe vë në pikëpyetje standardet normative të bazuara në epistemologjinë e femrës. Heshtja e përvojave të grave dhe njohja e tyre diskutohet në të gjitha TFPK. Por pasojat e kësaj heshtje dhe zgjidhjet e mundshme për ndryshim janë të ndarë në kuptimin thelbësor të 'natyrës femërore' dhe në ndërtimin e kuptimit të gjinisë si praktikë e diskurseve. Analiza me bazë luftën është thelbësore në teorinë feministe. Larmia e qasjeve sillet nga rrëfimet historike të grave në luftë deri në shqyrtimin psikologjik të edukimit gjinor të fëmijëve. Teoria Feministe e Paqes dhe Konfliktit reflekton në nevojën e dukshmërisë së grave në konflikte dhe ka çuar në një kuptim më të gjerë të çështjeve të sigurisë. TFPK prezantoi ndërlidhshmërinë e të gjitha formave të dhunës: në familje, shoqëri, dhunë të bazuara shtetërore dhe ndër-shtetërore dhe dimensionin e saj gjinor. Këtu diskutohet në mënyrë kritike bashkëpunimin e 'Soul Beautiful' (Jean Bethke Elshtain, 1987) në makinanizëm të dhunës. Teoricienët e tanishëm të paqes dhe të konfliktit feminist, argumentojnë se lufta është përjashtim nga vendimmarrja; e cila posaçërisht prek gratë. Nëse gratë nuk lejohen në ushtri, ato në mënyrë implicite ndalohen nga një institucion parësor, i cili ndihmon në kodifikimin dhe krijimin e shtetësisë (Francine D'Amico, 1996). Sidoqoftë, të dy kornizat pajtohen që gratë japin një kontribut thelbësor në ruajtjen e paqes (Annette Weber, 2006).

Konfliktet kontribuojnë në numrin e madh të viktimave civile, në dhunën strukturore – dhuna e ushtruar ndaj njerëzve, kur nuk përmbushen nevojat e tyre themelore dhe në shkatërrimin e mjedisit. Studiuesit kritik të sigurisë, përkufizojnë sigurinë në kuptimin e kërcënimit që paraqet për mirëqenien dhe për mbijetesën e individit, si një kërcënim për sigurinë e individit, të mjedisit që e rrethon atë dhe të shtetit në të cilin ai jeton. Sipas teorisë feministe të Marrëdhënieve Ndërkombëtare kërcënimin ndaj sigurisë përfshin dhunën shtëpiake, përdhunimin, varfërinë, nënshtrimin gjinor, shkatërrimin ekologjik dhe luftën.

Teoricienët e feminizmit nuk e shohin fuqinë ushtarake si pjesë e arsenalit ushtarak për mbrojtjen kundër kërcënimit ndaj sigurisë nga shtetet tjera, por shpesh arsyetojnë se personeli ushtarak përbën kërcënim për sigurinë e individëve (veçanërisht për gratë). Gjithashtu, ushtria është konkurrenente për burimet e pakta, për të cilat gratë mund të kenë më shumë nevojë se burrat.

Duke parë efektet e luftës në këndvështrimin gjinor, ne zbulojmë se lufta është një konstrukt kulturor që varet nga miti i mbrojtjes. Mite të tillë kanë qenë të rëndësishme për t'i dhënë legjitimitet luftës. Ato kontribuojnë edhe për heqjen e legjitimitetit të paqes, e cila shoqërohet shpesh me karakteristika femërore, siç janë dobësia, lëshimet dhe idealizmi. Duke parë këto konstruksione femërore, mund të thellojmë të kuptuarit tonë për shkaqet e luftës, si edhe të shohim sesi forma të caktuara të të menduarit mbi sigurinë janë legjitimuar, ndërsa për të tjera është heshtur (Tickner, Sjoberg, 2010, pp. 252-253).

*Pasiguria ekonomike* – Analizat feministe të sigurisë ushtarake kanë parë ndikimin e dallimeve gjinore në luftë, veçanërisht atëherë kur këto dallime lidhen me sigurinë e individëve. Hulumtimet feministe për sigurinë ekonomike nënvizojnë veçantinë e prekshmërisë ekonomike së gruas. Ku dihet se ekzistojnë dallime të mëdha globale në statusin ekonomiko-social të gruas, në varësi të racës, klasës dhe të vendndodhjes gjeografike, gratë në raport të zhdrejtë me burrat, gjenden kudo në fund të shkallës ekonomiko-sociale. (Tickner, Sjoberg, 2010, p. 254)

Gratë zakonisht nuk paguhen për punët e shtëpisë që ato i kryejnë pasi që me perceptimin e ndarjes gjinore të punëve, punët e shtëpisë janë pjesë e sferës private që i takon 'ekskluzivisht' grave, kurse publikja njihet si bota e prodhimit që u takonte burrave. Ndërlidhja e publikes me privaten njihet edhe në rastin e studimit të përzgjedhur për këtë punim, ku nënat vetushqyese/bashkëshortet e viktimave civile bënin pjesë në pjesën private e që kryenin kryesisht

punët e shtëpisë kurse bashkëshortët e tyre i takonin pjesës publike të botës së prodhimit. Shumica e kategorisë së përzgjedhur nuk kanë pasur siguri ekonomike kur kanë humbur bashkëshortët e tyre gjatë luftës, ato kanë vuajtur pastaj barrë të trefishtë, për shkak se është dashur të kryejnë të dy rolet gjinore atë të burrit dhe gruas duke e shtuar këtu edhe sigurinë ekonomike.

*Interpretimi feminist i sigurisë* – Siguria është aq e rëndësishme, sa që shtetet sa herë që zhvillojnë luftëra dhe vendosin sanksione shkaktojnë dhunë strukturore në emër të ruajtjes ose rritjes së sigurisë. Sidoqoftë, duke ruajtur sigurinë e shteteve, anëtarët e komunitetit ndërkombëtar mund të dhunojnë jo vetëm sigurinë e qytetarëve të tyre, por edhe të qytetarëve të tjerë mjaft të marginalizuar, sidomos të grave e fëmijëve, të moshuarve, të varfërve dhe të sëmurëve. Teoricienët e rrymës feministe të MN e studiojnë sigurinë në nivelin individual dhe komunitar; ata vënë re se politikat e sigurisë lënë pasojë të ndryshme të gratë dhe, përgjithësisht, të njerëzit e marginalizuar dhe vendosin pikëpyetje natyrën e politizuar gjinore të koncepteve të tilla si lufta, siguria dhe shteti. Disa nga shkaqet e pasigurisë në nivel global përfshijnë edhe nënshtrimin gjinor dhe dhunën me bazë strukturore (Tickner, Sjoberg, 2010, p. 261).

Dhuna strukturore në rastin e studimit të nënave vetushqyese/bashkëshorteve të viktimave civile e cila ka ndodhur gjatë kohës së luftës së fundit në Kosovë ka ndodhur si pasojë vrasjes së bashkëshortëve të kësaj kategorie si kategori civile dhe e paarmatosur nga forcat e armatosura serbe, duke lënë kështu pasojë afatgjate për pjesën e marginalizuar, në këtë rast gratë e viktimave civile të luftës.



### **3. DEKLARIMI I PROBLEMIT**

#### **3.1 Formulimi i problemit dhe qëllimeve të hulumtimit**

Siç edhe u përmend në pjesën e hyrjes, ky punim do të bazohet kryesisht në Rregulloret/Ligjet për kategoritë e dala nga lufta, duke i krahasuar dy nga kategoritë kryesore, atë të familjeve të viktimave civile të luftës dhe familjet e dëshmorëve. Specifike e këtij krahasimi do të jenë bashkëshortet/të vejat/nënat vetushqyese të këtyre dy kategorive të të njëjtit Ligj/Rregullore si anëtare të familjes së ngushtë të viktimës civile përkatësisht dëshmorit, si të parat për nga radha për të drejtë trashëgimie të pensionit.

Arsyeja kryesore pse është zgjedh pikërisht kjo kategori është çështje personale, pasi që jam rritur nga një nënë vetushqyese e kategorisë së viktimave civile të luftës dhe pasi që studioj për politikën publike e në veçanti, politikën sociale në Kosovë, e kam ndjerë më se të arsyeshme që të trajtoj këtë kategori. Por në këtë punim jam munduar që të jem subjektive dhe po besoj që kam arritur të punoj në këtë temë duke lënë anash përjetimet dhe të kaluarën, e mbi të gjitha përjetimet e luftës.

Kam qenë e rrethuar nga nënat vetushqyese të viktimave civile të luftës, pothuajse gjatë gjithë jetës, dhe mënyra se si janë trajtuar këto gra nga shoqëria kosovare, institucionet e mbi të gjitha dallimet që janë bërë nga kategoritë tjera të luftës, në rastin pothuajse të njëjtë me familjet e dëshmorëve, përfshirë këtu ndryshimet që kanë ndodhur nga Rregullorja e UNMIK-ut , 1999, deri në ndryshimet që kanë ndodhur tutje deri në vitin 2019.

Kompensimet që i marrin kategoritë e dala nga lufta e fundit në Kosovë, përfshijnë edhe përkujdesjen shëndetësore dhe lehtësime të formave të ndryshme por që ekzistojnë prapë dallimet në mes të kategorive të dala nga lufta, që në fakt ngjallë edhe pakënaqësi në mes të këtyre kategorive.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është evidentimi i humbjeve njerëzore të ndodhura gjatë viteve '98-'99 si dhe pasojat që janë përcjellur pastaj te familjarët e viktimave civile nga paslufta e tutje, konkretisht të bashkëshorteve (të vejat) e viktimave civile të luftës.

### 3.2 Objektivi kryesor dhe objektivat specifike të punimit

Objektivi kryesor i këtij punimi është që të tregoj pozitën në shoqërinë kosovare të nënave vetushqyese/bashkëshorteve të viktimave civile të luftës dhe të shoh përmes pyetjeve dhe hipotezave huluntuese të gjeturat për kategorinë specifike. Gjithashtu, përmes krahasimit në mes të kategorive të dala nga lufta si dhe rishikimit të literaturës për kategorinë në fjalë, me bazë kryesore në Rregulloret/Ligjet me të cilat janë përfaqësuar kjo kategori do t'i përgjigjem pyetjeve dhe hipotezave huluntuese të këtij punimi.

Objektivat specifike të këtij punimi janë përcaktimi i vendit të studimit që në këtë rast është Kosova, lufta e vitit 1998-1999 dhe ngjarje tjera pasuese të cilat kanë sjellë pastaj kategoritë e dala nga lufta si pasojë e asaj çka ka ndodhur gjatë luftës. Caktimi dhe kategorizimi i kategorive të dala nga lufta, këtu unë kam zgjedhur kategorinë e viktimave civile të luftës dhe pjesa kryesore e këtij objektivi janë nënat vetushqyese/bashkëshortet e viktimave civile si kategori specifike e Rregullores/Ligjeve për kategoritë në fjalë.

Objektivat specifike do të bazohen në përdorimin e teorisë feministe e cila tutje do të mbështetet mbi të gjeturat nga terreni. Dhuna strukturore në shoqëritë të cilat kanë dalë nga post-konflikti do të jetë bazë për objektivat specifike të këtij punimi. Këtu pastaj do të identifikohen institucionet që përfaqësojnë këto kategori.

Të gjeturat e këtij punimi janë punë kërkimore tri vjeçare specifike për kategorinë e viktimave civile të luftës, nënat vetushqyese/bashkëshortet e kësaj kategorie, të bazuara nga rishikimi i literaturës dhe të gjeturat nga terreni.

### 3.3 Pyetjet dhe hipotezat hulumtuese

Duke u bazuar në analizën dhe rishikimin e literaturës për kategoritë e dala nga lufta, Rregulloren/Ligjet, si dhe mbi teorinë feministe dhe teorinë feministe të paqes dhe konfliktit, pyetjet hulumtuese të këtij punimi janë:

*1. Cila është pozita dhe roli i nënave vetushqyese/të vejave të viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë 1999-2019?*

*2. Pse ka dallime në mes të të vejave/bashkëshorteve të kategorive të dala nga lufta (familjet e dëshmorëve dhe viktimave civile) ?*

Analiza mbi kategoritë e dala nga lufta është aktuale dhe nuk ka shumë studime/publikime për kategorinë specifike të viktimave civile konkretisht të nënave vetushqyese/bashkëshorteve të kësaj kategorie në Kosovë. Një prirje në rritjen e kërkimit në studimet e pas luftës integron ndërtimin e paqes dhe zhvillimin me njohuri nga drejtësia tranzicionale për të përmirësuar të kuptuarit tonë se si shoqëritë shërohen nga luftërat (Baker, 2016). Një lidhje e rëndësishme mund të identifikohet në sferën e fuqizimi socio-ekonomik i viktimave përmes transferimeve të parave, politikave sociale dhe kujdesit shëndetësor falas.

Drejtësia tranzicionale shqetësohet për drejtësinë për viktimat. Unë do të kontribuoj në këto diskutime duke parë gjenezën e kompensimit, të përkufizuar si një grup përfitimesh materiale të njohura si in-kind të ardhurat/përfitimet për viktimat e luftës, si një pjesë veçanërisht e frytshme për të studiuar se si shtetet ofrojnë kompensim për popullatat më të prekur nga situata e krijuara në luftë. Ky konceptim i ngushtë i kompensimit adreson vetëm politikat socio-ekonomike të adoptuara nga shtetet e pas luftës për të ndihmuar viktimat e popullsisë së tyre, humbjet dhe dëmet e së cilës nuk mund të zhbëhen (HRONEŠOVÁ, 2018). Prandaj do të mundohem të vërtetoj hipotezat potenciale:

*H1. Sa më e munguar të jetë mos-mbështetja ekonomike dhe psiko-sociale nga institucionet shtetërore për këtë kategori, aq më e vështirë do të jetë pozita e tyre në shoqëri.*

*H2. Deri sa nuk rregullohet legjislacioni edhe për nënat vetushqyese/të vejat e viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë, do të ketë dallime me kategorinë e dëshmorëve.*

### **3.4 Rëndësia dhe rezultatet e pritshme te punimit**

Ky punim do të jetë i bazuar mbi rishikimin e literaturës, Rregullores/Ligjeve, shtjellim të mëturjeshëm të institucioneve të cilat përfaqësojnë kategorinë e përzgjedhur si dhe të dhënat nga terreni me raste konkrete të nënave vetushqyese/bashkëshorteve të viktimave civile, duke nxjerrë kështu të dhëna të rëndësishme dhe duke i krahasuar ato pastaj mes dy kategorive, asaj të viktimave civile dhe familjeve të dëshmorëve. Kategoria në fjalë, viktimat civile të luftës, nuk është se ka pasur ndonjë trajtim në sferën shkencore dhe ky punim do të mundohet të sjellë sadopak informim dhe të gjetura, sidomos në pjesën e gjetjeve dhe të dhënave për kategorinë nënave vetushqyese/bashkëshorteve të viktimave civile të luftës së vitit 1999 në Kosovë.

### **3.5 Kufizimet e punimit**

Punimi i Masterit do të bazohet në legjislacionin ekzistues së Republikës së Kosovës për kategoritë e dala nga lufta, ndryshimet që kanë ndodhur në legjislacion nga viti 1999 e tutje, si dhe krahasimet e legjislacioneve të shteteve që kanë pasur situatë të ngjashme me atë të Kosovës.

Baza e këtij punimi do të jetë Republika e Kosovës, kryesisht rajonet më të prekura nga lufta. Të dhënat e përdorura në këtë studim janë rezultat i punës kërkimore tri vjeçare për kategorinë specifike. Një muaj pune në terren të intervistave me nënat vetushqyese/bashkëshortet e viktimave civile, me të cilat kam realizuar gjashtë intervista. Një intervistë me përfaqësuesin e shoqatës që i përfaqëson kategorinë e viktimave civile të luftës. Një intervistë me përfaqësuesin e ministrisë, departamenti për kategoritë e dala nga lufta. Për të dhënat mbi humbjet njerëzore në Kosovë gjatë luftës së vitit 1998-1999 jam bazuar në të dhënat e Fondit për të Drejtën Humanitare – Kosovë, në mungesë të të dhënave zyrtare nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës .

## **4. METODOLOGJIA**

### **4.1 Metodologjia e aplikuar**

#### **4.1.1 Modelet e hulumtimit: Niveli mikro dhe Niveli makro.**

Për të iu qasur temës së përzgjedhur të studimit kam vendosur që të përdor të dy njësitë e mbledhjes së të dhënave. Niveli mikro, që për fokus kam pasur individin si ‘aktor shoqëror’, si dhe nivelin makro ku për fokus kam pasur organizatën, institucionin, njësinë dhe strukturën shoqërore (Matthews, 2010, p. 114).

#### **4.1.2 Qasja historisë së jetës**

Mbledhja e të dhënave ku pjesëmarrësve u kërkohet të tregojnë historinë e jetës së tyre, duke u përqendruar te ngjarjet e përbashkëta, e konsideroj si model hulumtimi afatgjatë, sepse pjesëmarrësve u është kërkuar që të tregojnë dhe të reflektojnë për të njëjtat çaste kyçe të jetës së tyre (Matthews, 2010, p. 126).

#### **4.1.3 Rastet e studimit – rast kritik dhe rast ekstrem ose unik**

Kam zgjedhur këto dy raste të studimit për shkak se, me rastin kritik do të mundohem të testoj teorinë dhe hipotezat e përdorura për këtë studim, në këtë rast nëse ka potencial të qëndroj teoria ose jo. Ngjarjet e ndodhura të rastit të përzgjedhur do të më japin mundësinë të studioj se çka ka ndodhur si rezultat i këtij ndryshimi, kurse rastin unik e kam përdorur për shkak se kategoria e përzgjedhur është e ndryshme nga çdo situatë apo grup tjetër, ky rast është i vetmi ku gjendet kombinimi i caktuar i njerëzve dhe ngjarjeve (Matthews, 2010, p. 128).

#### **4.1.4 Hulumtimi vlerësues**

Vlerësimi në ndërhyrje apo ndryshim të caktuar dhe rezultatet e sjella, funksionimi i procesit, si të përmirësohet një ndërhyrje apo proces, kostot e procesit dhe çka funksionon ose jo dhe pse (Matthews, 2010, pp. 132-133).

## 4.2 Metodatat e aplikuara

*Metodat e hulumtimit: Metoda cilësore – histori dhe rrëfime ku përfshihen kuptime subjektive, ndjenja, mendime dhe bindje.*

Arsyeja kryesore pse unë kam zgjedhur metodën cilësore/kualitative për të nxjerrë të dhënat për këtë punim është sepse qasjet ontologjike dhe epistemologjike janë interpretuese duke u nisur nga fakti se realiteti i kategorisë së përzgjedhur, nënave vetushqyese/bashkëshortëve të viktimave civile të luftës, është konstrukt shoqëror. Pyetjet e hulumtimit do të marrin përgjigje përmes përshkrimit dhe shpjegimit të ngjarjeve dhe mbledhjes së përvojave të pjesëmarrësve. Gjatë punimit unë kam pasur një ide të përgjithshme të asaj se çfarë kam kërkuar për kategorinë në fjalë. Pastaj modeli/strategjia e hulumtimit mund të e jetë e ndryshueshme dhe evolucionare. Qasja cilësore ndaj kësaj kategorie gjatë mbledhjes së të dhënave ka qenë subjektive pasi që jam përfshirë në mbledhjen e këtyre të dhënave si qenie shoqërore. Personalisht kam intervistuar dhe mbledhur të dhënat për kategorinë specifike (Matthews, 2010, p. 142).

*Metoda e mbledhjes së të dhënave cilësore – Intervistat e gjysmë-strukturuara/të pastrukturuara, Mbledhja e dokumenteve që lidhen me pyetjet e hulumtimit dhe bërja e pyetjeve për këto dokumente, Rrëfimi, Vrojtimi.*

Kam zgjedhur intervistat e gjysmë-strukturuara/të pastrukturuara për shkak se në këtë mënyrë unë kam dhënë pjesëmarrësve në hulumtim mundësinë që të flasin për temat dhe çështjet që ato kanë dashur t'i flasin në mënyrën e tyre, duke marrë parasysh se këto intervista kanë shpalosur të dhëna që kanë qenë tejet të ndjeshme me vet faktin se kategoria e përzgjedhur kanë treguar edhe për mënyrën e vdekjes së bashkëshortëve të tyre. Të gjitha të intervistuarat e këtij punimi më kanë dhënë leje që të i publikoj identitetin pavarësisht ndjeshmërisë së të dhënave që ato kanë rrëfyer. Në këtë mënyrë nënat vetushqyese/bashkëshortet e viktimave civile të luftës kanë treguar rrëfimet dhe historitë e tyre që kanë qenë të përbashkëta, ku më pas kam analizuar mënyrën se si ato kanë treguar historitë e tyre. Vrojtimi ka qenë pjesë e këtij hulumtimi, kam përdorur vrojtimin me pjesëmarrje ku kam marrë njohuri më të thella për kategorinë e përzgjedhur, nuk kam pasur ndonjë qëllim specifik për vrojtimin mbi kategorinë në fjalë, qëllimi ka qenë i përgjithshëm (Matthews, 2010, p. 147).

*Të dhënat: Të dhënat parësore dhe dytësore, Të dhënat me gojë, me shkrim ose jo verbale/pamore, Individuale.*

Të dhënat parësore janë të dhënat që i kam mbledhur drejtpërsëdrejti, siç edhe i trajtova më lartë. Të dhënat dytësore që janë përdorur në këtë punim janë të dhënat nga organizata joqeveritare, Fondi për të Drejtën Humanitare-Kosovë, konkretisht në databazën e këtij Fondi „Libër Kujtimi i Kosovës,, të dhënat nga MPMS - Departamenti i kategorive të dala nga lufta, të dhënat që i kam nxjerrë nga kjo ministri në vitin 2018, edhe pse kam parashtruar kërkesë zyrtare për qasje në të dhënat për kategoritë e dala nga lufta, përkatësisht për viktimat civile të luftës, nuk kam marrë asnjë përgjigje nga ana e ministrisë në asnjë lloj forme të komunikimit. Të dhënat nga ligjet ekzistuese për kategoritë e dala nga lufta. Të dhëna joformale nga organizata që përfaqëson kategoritë civile të luftës (Matthews, 2010, pp. 148-151).

*Zgjedhja e kampionit: Kampionimi i qëllimshëm – kampioni homogjen dhe kampioni i rasteve ekstrem.*

Kam zgjedhur kampionimin e qëllimshëm, si qasje e kampionit jo-probabilitar dhe këtë e kam bërë me qëllim. Këtë qasje e kam lidhur me studim të thelluar në shkallë të vogël, për kategorinë e nënave vetushqyese/bashkëshorteve të viktimave civile të luftës, ku modelet e përzgjedhura të hulumtimit janë mbështetur në zgjedhjen e të dhënave cilësore ku edhe jam fokusuar në eksplorimin dhe interpretimin e përvojave dhe perceptimeve të kategorisë së përzgjedhur. Në këtë rast nuk kam pasur synim që të krijoj një kampionim që të jetë statistikisht përfaqësues i kategorisë së përzgjedhur. Rastet që kam zgjedhur kanë qenë të qëllimshme dhe në këtë mënyrë më kanë dhënë mundësinë që të eksploroj pyetjet e hulumtimit dhe të zhvilloj dhe interpretoj tutje teoritë e përdorura. Rastet që kam zgjedhur janë të atilla që do të zbulojnë dhe hedhin dritë mbi fushën e studimit të përzgjedhur. Tek kampioni i qëllimshëm kam zgjedhur dy lloje të kampionimit të cilat më kanë mundësuar të studioj temën në thellësi, ato janë; kampioni homogjen - ku rastet e përzgjedhura i takojnë ose i përkasin të njëjtit grup shoqërorë dhe kanë të njëjtën karakteristikë, si dhe kampioni i rasteve ekstreme ku kam zgjedhur rastet sepse janë të skajshme ose deviante, duke u munduar kështu që të hedhë dritë mbi këtë dukuri shoqërore nga një këndvështrim tjetër, ndryshe nga ai që merret zakonisht, e që në këtë rast jam munduar t'i krahasoj dy kategori të dala nga lufta në Kosovë, kategorinë e viktimave civile dhe atë të dëshmorëve (Matthews, 2010, pp. 152-173).

## 5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

### 5.1 Kronologji mbi luftën e viteve '98-'99 dhe pasojat e saj

Kosova ishte shteti i fundit që u formua pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Si shumica e shteteve anëtare të Jugosllavisë u ndesh me një konflikt të përgjakshëm me shtetin serb në krye me Slllobodan Millosheviqin, lufta ishte veprimi i fundit që u ndërmor pasi, dhuna sistematike që prekte drejtpërdrejtë jetën e qytetarëve shqiptarë të Kosovës kishte filluar qysh në vitin '89, duke u mohuar kështu të drejtat themelore me justifikimin se shumica shqiptare po kërcënonte me zhdukje pakicën serbe.

Sistemi serb, njëlloj si apartheidi, përzuri shqiptarët nga vendet e tyre të punës dhe nga sistemi arsimor, ndaloi ndihmat qeveritare dhe urdhëroi burgosje masive e shtypje të rënda mbi popullatën shqiptare. Në vitet e para të këtij diskriminimi sistematik shqiptarët praktikuan rezistencën pa dhunë e paqësore dhe ndërtuan institucionet e tyre paralele. Por në mesin e viteve të '90-ta frustrimi i popullatës shqiptare mbi diskriminimin sistematik i hapi rrugë rebelimit të armatosur në Kosovë të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) por gjithashtu edhe organizim të forcave serbe kundër këtyre kryengritësve. Vitet '98-'99 tërhoqën vëmendjen ndërkombëtare me sulmet e forcave serbe kundër civilëve shqiptarë, ku edhe ndërhyjnë forcat e NATO-s për të ndaluar luftën/konfliktin.

Bombardimet e NATO-s zgjatën 4 muaj (Mars-Qershor 1999), gjatë kësaj kohe 1.4 milion shqiptarë u zhvendosën me dhunë nga shtëpitë e tyre duke u urdhëruar kështu edhe ikjen nga vendi. Rreth 13.000 është numri i viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë (RHNJK-P 1998-2000,RAFDH,2010). Qëllimi kryesor i këtij punimi është evidentimi i humbjeve njerëzore të ndodhura gjatë viteve '98-'99 si dhe pasojat që janë përcjellur pastaj te familjarët e viktimave civile nga paslufta e tutje, konkretisht të bashkëshorteve të viktimave civile të cilat më tutje do tu referohem me termin nëna vetushqyese.

Nga Qershori 1999 deri në Shkurt 2008, Kosova ishte nën mbrojtjen e bashkësisë ndërkombëtare të udhëhequr nga OKB-ja dhe e mbështetur nga trupat e NATO-s.



## 5.2 Konceptet

Fillimisht në këtë pjesë do të mundohem të trajtoj konceptet teorike kryesore që do të përdoren më së shumti në këtë punim.

Me rregulloren e UNMIK-ut Nr.2000/66 mbi beneficionet e invalidëve të luftës së Kosovës dhe për më të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë, termi ‘viktimë civile’ mbulohej me termin ‘invalidët e luftës’ dhe ‘atyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë’ ku përfshinte edhe pjesëtarët e ish-UÇK-së (UNMIKONLINE.ORG, 2000).

Termat ‘viktimë’ apo ‘viktimë civile e luftës’ –konsiderohet personi i cili ka vdekur nga pasojat e luftës së fundit në Kosovë, prej 27.02.1998 deri me 20.06.1999 (sipas Ligji Nr. 02/L-2). Viktimë Civile e Luftës- personi i cili është vrarë apo është plagosur, nga forcat e armikut, e më vonë ka vdekur brenda periudhës 27.02.1998 deri me 20.06.1999, si dhe personat që kanë pësuar si pasojë e luftës brenda tri (3) viteve që nga përfundimi i luftës nga mjetet shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës (Kosoves, 2011).

Si anëtarë të familjes së ngushtë me anë të ligjit Nr.02/L-2 dhe Ligjit Nr.04/L-054 janë fillimisht bashkëshorti, bashkëshortja pastaj fëmijët, prindërit, thjeshtrit dhe bashkëshorti/ja jashtëmartesore. Ku edhe qëndron arsyeimi i temës se këtij punimi tek bashkëshortet apo si do t’u referohem tutje, nënat vetushqyese të viktimave civile të luftës si kategori kontribut-dhënëse e ndërtimit të Kosovës së pasluftës.

Termi nënë vetushqyese (bukfalisht) nënkupton kategorinë e femrave, grave të cilat i/e rrisin fëmijën/et pa përkujdesjen e bashkëshortit, babait ose partnerit.

### 5.3 Shtjellimi i problematikës sipas qasjes së autorit

Ashtu edhe si u trajtuan në pjesën e parë termat e përgjithshëm të këtij punimi, statusin e viktimës civile të luftës së fundit në Kosovë, e përcaktoi fillimisht ‘Rregullorja e UNMIK-ut’ e cila hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2000, me anë të një urdhërese administrative të lëshuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (UNMIKONLINE.ORG, 2000). Departamenti Administrativ i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me anë të rregullores së lartcekur do të kryente shërbimet e nevojshme për këtë kategori. Si pjesë e ‘ më të afërmeve’ kryesisht ishin bashkëshortet e viktimave civile, pasuar nga fëmijët, prindërit, kujdestarët e fëmijëve dhe të tjerët.

Nënat vetushqyese të kësaj kategorie që gëzonin të drejtën për beneficione me anë të rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/66 dhe nr. 2006/29 gëzonin një shumë simbolike të të mirave materiale nga buxheti i konsoliduar i atëhershëm, rreth 40 EUR konkretisht 60 EUR.

Këtu, nënkuptojmë se nën ombrellën e kësaj rregullore të gjitha kategoritë e dala nga lufta e fundit në Kosovë trajtoheshin njëjtë dhe shuma e pensionit që e merrnin ishte e njëjtë për të gjithë. Gjithashtu kjo rregullore kishte për qëllim kryesorë që të drejtë primare në pension të kishin bashkëshortet e kategorive të dala nga lufta.

Pas shfuqizimit të rregullores së UNMIK-ut, me ligjin Nr. 02/L-2 të vitit 2006 baza e pensionit familjar të viktimës civile të luftës ishte 100% nga paga minimale në Kosovë.

Pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, me ligjin nr. 04/L-054 pensioni i familjes së viktimës civile të luftës së fundit në Kosovë është 135 EUR, kjo shumë pastaj rritet në përqindje nëse familja e ngushtë e viktimës civile ka dy viktima civile, rritet për 20%; tri viktima civile, rritet në 30%; katër viktima civile, rritet në 40% dhe pesë viktima civile, rritet në 50%.

Pensioni për këtë kategori të shoqërisë së pasluftës vazhdoi të pasoj ndryshime, deri në vitin 2017 ky pension ishte rritur në 169 EUR, ky pension do të rritet me rritjen e pagës minimale në vend. Përpos pensionit familjar, bashkëshortet apo nënat vetushqyese përfitojnë perkujdesje shëndetësore primare dhe sekondare pa kompensim në institucionet shëndetësore publike, lirim nga tatimi në pronë , nëse familja është në gjendje të rëndë materiale dhe tarifë të lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike për nevoja personale nëse familja e ngushtë përballet

me gjendje të rëndë ekonomike dhe i plotëson kriteret sipas skemës së asistencës sociale (UNMIKONLINE.ORG, 2000).

Krahasuar me familjet e dëshmorëve kjo kategori përfiton vetëm përkujdesje shëndetësore primare dhe sekondare, kurse familjet e dëshmorëve edhe përkujdesje terciare. Kurse për shërbimet e tjera të lartcekura familjet e dëshmorëve përfitojnë automatikisht duke shtuar këtu edhe benefite të tjera shtesë. Nuk do të ndalem të krahasoj këto dy kategori pasi, jam përqendruar vetëm në njërin, konkretisht në nënat vetushqyese të kategorisë së viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë.

**5.3.1 Financimi i kategorive të dala nga lufta** - Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/66 u themelua një fond i veçantë për sigurimin e ndihmave të veçanta për invalidët e luftës me të drejtë shfrytëzimi dhe për më të afërmit e atyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë, duke përfshirë pagesa të kufizuara financiare nga burimet e ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe kontributet plotësuese përmes Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Ky fond i veçantë u administrua nga Departamenti Administrativ i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Ligji Nr. 02/L-2 financohej nga buxheti i institucioneve të asokohshme dhe ekzekutohej nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Viktimat Civile.

Pas formimit të institucioneve shtetërore, me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, programet e pensioneve në Kosovë përfshirë edhe ato të kategorive të luftës, financohen nga buxheti i shtetit. Buxheti i shtetit financohet nga taksat, përgjithësisht nga taksat e konsumit, tregtisë ndërkombëtare, të ardhurat personale dhe të ardhurat nga shërbimet qeveritare.

Ministria është përgjegjëse për ekzekutimin e pagesave të kategorive të luftës. Sidoqoftë, listat e përfituesve dhe shumat që ata marrin janë përgatitur nga "Zyra e Kategorive të Luftës" në Zyrën e Kryeministrit dhe Komitetin e Qeverisë për ish të dënuar politikë. Në të dy këto institucione, shoqatat që përfaqësojnë grupet sociale - Shoqata e Veteranëve, Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidëve të UCK-së dhe Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës - luajnë një rol vendimtar në përcaktimin e të drejtave të përfitimit. Të dy institucionet janë ose kryesohen nga kryetari i shoqatës përkatëse (Mustafa, 2017).

Në bazë të rishikimit dhe analizës mbi Rregulloret/Ligjet për kategoritë e dala nga lufta, vërejmë se këto kategori kanë pasur trajtim dhe beneficione të njëjta me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/66 , kjo Rregullore në parim kishte integrimin e të gjitha kategorive të luftës në veçanti ish-ushtarët e UCK-së (Mustafa, 2017).

Ndryshimet thelbësore vijnë me ardhjen në fuqi të Ligjit Nr. 02/L-2 të Kuvendit të Kosovës së vitit 2006, ku edhe bëhet kategorizimi i kategorive të dala nga lufta. Familjet e dëshmorëve, përveç se përfitojnë pensione me përqindje më të madhe se sa kategoritë e viktimave civile. E njëjta vlen edhe për të drejtat që i ndajnë këto dy kategori atë të familjes së dëshmorëve dhe viktimave civile, sipas Nenit 11 për të drejtat e anëtarëve të familjes së viktimës civile të luftës, përfshijnë;

1. Pensionin familjar civil të luftës,
2. Përkujdesjen shëndetësore primare pa kompensim në institucionet shëndetësore publike,
3. Lirimin nga tatimi në pronë, nëse familja është në gjendje të rëndë materiale,
4. Tarifën e lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike, nëse familja është në gjendje të rëndë material.

Kurse në bazë të Nenit 6 për Të drejtat e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, përfshijnë;

1. Pensionin familjar,
2. Përparësi në punësim në kushte të barabarta,
3. Lehtësime tatimore dhe doganore,
4. Përparësi regjistrimi në institucione arsimore,
5. Bursa për shkollim,
6. Vendorsje në konvikte pa kompensim,
7. Tekste shkollore falas për arsimin fillor dhe të mesëm,
8. Përkujdesjen e banimit,
9. Tarifë të lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike,
10. Lirimin nga pagesa e taksave gjyqësore, administrative dhe publike,
11. Lirimin nga tatimi në pronën e paluajtshme,
12. Përkujdesje shëndetësore falas në institucione publike,
13. Vendorsjeje pa kompensim në shtëpitë e personave të moshuar.
14. Lirimi nga shpenzimet e administratës në shkollimin universitar.

Baza e pensionit familjar për familjen e dëshmorit është 180 % nga paga minimale e realizuar në Kosovë shtuar këtu edhe përqindjen për humbjen e dëshmorit të dytë kjo përqindje rritet në 20%, dëshmori i tretë 30%, dëshmori i katërt 40%, dhe më shumë se 5 dëshmorë përqindja rritet në 50%. Krahasuar me kategorinë e viktimave civile që nuk merrnin përqindje shtesë nëse kanë pasur anëtar tjerë të vrarë në luftë të kategorizuar si viktimë civile. Kategoria e viktimave civile të luftës në këtë rast përfitonte vetëm bazën prej 100% nga paga minimale në Kosovë. Paga minimale gjatë periudhës kur e ky ligj ka hyrë në fuqi nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2006 nuk ka qenë e rregulluar, paga minimale është rregulluar në vitin 2011.

E përbashkëta e këtyre dy kategorive të dala nga lufta është se anëtarë të familjes së ngushtë në kuptim të këtij ligji janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), thjeshtri, thjeshtra, prindërit, njerku, njerka, si dhe bashkëshorti/bashkëshortja jashtëmartesore.

Këtu bashkëshortet e këtyre dy kategorive bëjnë pjesë si trashëgimtare të para të pensionit në bazë të dispozitave të trashëgimisë. Njëjtë ndodhë edhe në rastin nëse bashkëshorti/ja që lidh martesë të re i humb të drejtat e parapara me këtë Ligj të cilat i ka shfrytëzuar si anëtar i familjes së dëshmorit përkatësisht viktimës civile.

Kategoritë e dala nga lufta kanë funksionuar me Ligjin Nr. 02/L-2 deri më 1 Janar 2012 kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 04/L-054 “LIGJ PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E DËSHMORËVE, INVALIDËVE, VETERANËVE, PJESËTARËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, VIKTIMAVE CIVILE DHE FAMILJEVE TË TYRE” i cili funksionon deri sa të shfuqizohet me një ligj tjetër. Në shtojcën e Ligjit Nr. 04/L-054 tregohen edhe shumat të cilat familjet e kategorive të dala nga lufta marrin për kategorinë të cilës i përkasin, kështu për familjet e dëshmorëve lartësia e pensioneve është 358,50 EUR duke shtuar edhe përqindjen e lartcekur të ligjit paraparak. Kurse për familjet e viktimave civile lartësia e pensionit është 135,00 EUR, përfshirë edhe përqindjen për anëtarin e dytë 20%, anëtarin e tretë 30%, anëtarin e katërt 40%, kurse më shumë se 5 anëtarë 50% (anëtarë i vrarë gjatë luftës i konsideruar në bazë të ligjit si viktimë civile).

Nuk po ndalem të trajtoj dallimet kryesore në të drejtat sepse këto dy kategori kanë dallime të mëdha mes vete në të drejtat që ju takojnë me ligjin ekzistues, njëjtë sikurse në ligjin paraparak

këtu i shtohen të drejta shtesë kategorisë së familjeve të dëshmorëve kurse asaj të viktimave civile jo.

Po shtoj këtu Nenin 24 - Lartësia e shumës së pensioneve ku tregohet edhe për pjesën se si ky ligj do të financohet, ndër të tjera thuhet: Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve dhe benficioneve të përcaktuara me këtë ligj.

Deri në vitin 2019 ky ligj ka pësuar disa ndryshime në lartësinë e pensioneve për kategoritë e dala nga lufta, kurse për kategorinë e viktimave civile të luftës, me rritjen e fundit të shumës së pensionit, kjo kategori tani përfiton 169,00 EUR. Kjo shumë do të pësoj ndryshime me pagën minimale në Kosovë.

Për sqarime të mëtutjeshme gjeni të bashkëngjitur Tabela 1. Ndryshimet në pensionet e kategorisë së viktimave civile të luftës 1999-2019, punuar nga autorja e punimit.

## 5.4 Familja e Viktimës Civile – Lartësia e Pensioneve 1999-2019-Albonita Aliu

<b>Rregullorja/Ligji</b>	<b>Viti</b>	<b>Shuma</b>	<b>% + 2 anëtarë</b>	<b>% + 3 anëtarë</b>	<b>% + 4 anëtarë</b>	<b>% +5 anëtarë</b>
Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/66 dhe nr. 2006/29	1999-2006	40 – 60 EUR				
Ligji Nr. 02/L-2	2006-2008	100% nga paga minimale				
Ligji nr. 04/L-054	2008	90 EUR				
Shtojca e ligjit nr. 04/L-054	2011	135 EUR	20 %	30 %	40 %	50 %
Ndryshimet ne ligjin nr.04/L-054	2013- ...	169 EUR	20%	30%	40%	50%

*Tabela 1. Ndryshimet në pensionet e kategorisë së viktimave civile të luftës 1999-2019*

## 5.5 Mbledhja të dhënave nga Fondi për të Drejtën Humanitare

Edhe pse kanë kaluar 20 vite nga përfundimi i luftës në Kosovë, nuk ekziston asnjë databazë e krijuar nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës e cila ka të regjistruara, të paktën humbjet njerëzore gjatë luftës. Ky fakt e ka bërë edhe më të vështirë qasjen në dokumentet mbi vrasjet në popullatën civile e cila lidhet drejtpërdrejt me temën të cilën jam duke u munduar ta shtjelloj. Si bazë për vazhdimin e mëtutjeshëm të këtij punimi, në mungesë të të dhënave zyrtare, unë kam përdorur Bazën e të dhënave të Librit të Kujtimit të Kosovës nga Fondi për të Drejtën Humanitare dhe nga Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë.

Në bazë të 31.600 dokumenteve është dokumentuar vdekja ose zhdukja në lidhje me luftën e 13.535 njerëzve, nga data 1 janar e vitit 1998 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2000, dhe atë 10.812 shqiptarë, 2.197 serb dhe 526 romë, boshnjak, malazez dhe joshqiptarë të tjerë. Shikuar sipas statusit të viktimave, jetën e kanë humbur ose janë zhdukur në lidhje me luftën 10.317 civilë, prej të cilëve 8.676 shqiptarë, 1.196 serb dhe 445 romë dhe të tjerë, si dhe 3.218 pjesëtarë të formacioneve të armatosura, prej të cilëve 2.131 pjesëtarë të UÇK-së dhe FARKut, 1.084 pjesëtarë të forcave serbe dhe tre pjesëtarë të KFOR-it. Në bazë të 4.838 dokumenteve<sup>1</sup>, midis të cilave 2.136 deklaratatë të dëshmitarëve/anëtarëve të familjes, është vërtetuar se në lidhje me luftën në vitin 1998 jetën e kanë humbur ose janë zhdukur 2.156 njerëz, prej të cilëve 1.804 shqiptarë, 289 serbë dhe 63 romë dhe të tjerë. Të dhënat tregojnë se në mesin e viktimave civile janë 1.100 shqiptarë, 132 serbë, 46 romë dhe të tjerë, kurse të atyre ushtarake (878), 703 pjesëtarë të UÇK-së dhe 175 pjesëtarë të UJ/MPB të Serbisë.

Sipas të dhënave nga 22.041 dokumente<sup>2</sup>, në mesin e të cilave 9.592 janë deklaratatë të dëshmitarëve dhe të anëtarëve të familjes, 10.122 viktima (8.701 shqiptarë, 1.191 serbë dhe 230 romë dhe të tjerë) e kanë humbur jetën ose janë zhdukur në lidhje me luftën në periudhën prej datës 1 janar – 14 qershor 1999. Viktima civile janë 7.903, prej të cilëve 7.346 shqiptarë, 385 serbë dhe 172 romë dhe të tjerë. Nga gjithsejtë 2.219 viktima ushtarake, janë 1.354 pjesëtarë të UÇK-së dhe 865 pjesëtarë të UJ/MPB të Serbisë. Të dhënat nga 3.558 dokumente<sup>3</sup>, në mesin e të cilëve janë 1.472 deklaratatë të dëshmitarëve ose të anëtarëve të familjes, vërtetojnë se në periudhën prej datës 14 qershor të vitit 1999 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2000, në lidhje me



luftën janë vrarë ose janë zhdukur 1.257 njerëz, prej të cilëve 717 serbë, 307 shqiptarë dhe 233 romë, boshnjakë dhe të tjerë. Në periudhën prej datës 24 mars deri në datën 9 qershor të vitit 1999, në eksplodimin e granatave, nga predhat dhe bombat e hedhura nga NATO-ja, janë zhdukur 758 njerëz: 488 në Kosovë (249 shqiptarë, 202 serbë dhe 37 romë dhe të tjerë), 260 në Serbi dhe 10 në Mal të Zi. Në mesin e viktimave janë 453 civilë, prej të cilëve 220 shqiptarë, 205 serbë, 28 romë dhe të tjerë, si dhe 305 pjesëtarë të formacioneve të armatosure, prej të cilëve 276 pjesëtarë të UJ/MPB të Serbisë dhe 29 pjesëtarë të UÇK-së. Të dhënat bazohen në 1.468 dokumente dhe 539 deklaratat të dëshmitarëve dhe të anëtarëve të familjes, të dhëna të FDH dhe FDHK (FDHK, 2015).

Pastaj kam përdorur të dhënat nga 'Evaluimi i databazës së Librit të Kujtimit të Kosovës' nga Jule Krueger dhe Patrick Ball ku tutje ata kanë shpjeguar ndarjen dhe seleksionimin e të dhënave: Statusin e viktimës – ku kam përdorur pjesën më të dhëna për viktimat civile e që numri i tyre është 10305; Pastaj kam përdorur pjesën e cila lidhet me shkakun e vdekjes dhe kam përzgjedhur të dhënat që ndërlidhen vrasje të civilëve – numri i tyre është 8526; Në bazë të këtij studimi kam nxjerrë pastaj të dhëna edhe për gjininë e viktimave – numri i të vrarëve të gjinisë mashkullore është 8472 apo 82.2%; Kombësia e viktimave ka qenë fusha tjetër në të cilën kam ndarë tutje punimin, e që kam përzgjedhur viktimat civile me etni shqiptare – numri i të cilëve është 8661 apo 84%; Pastaj kam analizuar vitin e lindjes së viktimave në bazë të këtij evaluimi të të dhënave dhe jam fokusuar tek të lindurit prej viteve 1945 e deri më 1985 ku tejkalojnë shifrat prej 100 viktima për vitin e lindjes e deri mbi 350 viktima për vitin e lindjes, duke i klasifikuar tutje me moshën e viktimës civile e cila fillon me ndarjen prej 15-19 vjeç e që kalon shifrat mbi 600 deri te mosha 60-64 vjeç, të klasifikuar në gjininë mashkullore; Tutje në klasifikimin e vitit të vrasjes së viktimës, numri më i madh i vrasjeve ka ndodhur gjatë vitit 1999 më së shumti gjatë muajve Mars, Prill dhe Maj; Tek Vendi/Komuna e vrasjes së viktimës, komunat më të prekura gjatë luftës janë Gjakova, Skënderaj, Rahoveci dhe Gllogoci (Ball&Krueger, 2015).

Në bazë të këtyre të dhënave kam zgjedhur pastaj dy nga këto komuna për realizimin e intervistave me nënat vetushqyese/bashkëshortet e viktimave civile, në komunën e Gjakovës dhe

komunën e Rahovecit – Krushë e Madhe. Si pjesë e të intervistuarave kam zgjedhur tutje rajone të caktuara për shkak të ngjarjeve/përjetimeve prej lokacioneve të caktuara, si shembull Prishtinën për shkak të ngjarjeve në fshatin Grashticë, Vushtrri – Masakrën e Studimes, Lipjan – vrasjen e viktimave civile në Hallaç të Vogël dhe tregimet e luftës për komunën e Malishevës.

## 5.6 INTERVISTAT

### 5.6.1 Të dhënat statistikore nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

4417 është totali i personave që përfitojnë nga skema për viktimat civile të luftës.

3191 është numri i bashkëshorteve të viktimave civile të luftës që përfitojnë nga kjo skemë.

Ato tutje kategorizohen edhe në:

Bashkëshorte me fëmijë ku numri i tyre është 1571,

Bashkëshorte pa fëmijë në 1620.

16 kujdestar të fëmijëve të viktimave civile.

1210 pjesa tjetër (fëmijët, prindërit dhe tjerë pjesëtar të familjes së viktimës civile të luftës).

***Qasje në të dhënat e MPMS – Departamenti i kategorive të dala nga lufta, Janar 2018.***

*Sqarim – Te dhënat nga MPMS janë te vitit 2018, kam kërkuar qasje ne te dhëna për kategoritë e dala nga lufta-viktimat civile te luftës, në Nëntor të 2019-tës por nuk më është aprovuar kërkesa nga MPMS, kështu që jam detyruar të punoj me të dhëna nga viti 2018.*

## 5.6.2 'Lidhja e Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës në Kosovë - Komunalja e Prishtinës' - Intervistë e me Rexhep Grabovci përfaqësues i shoqatës – Komunalja e Prishtinës

LIVCLK është themeluar në Shtator të vitit 1999 dhe mbulon kategoritë civile të luftës në Kosovë, invalidët civil dhe familjarët e viktimave civile. Në vitin 2000 me vendosjen e institucioneve të përkohshme të misionit të UNMIK-ut, LIVCLK ka aplikuar për regjistrim si shoqatë, pastaj njëjtë vepron me aplikim të përvjetshëm. Kjo shoqatë ka shtrirje pothuajse në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, në komunat ku nuk ka shtrirje si shoqatë, arsyeja kryesore është se nuk i'a kanë miratuar projekt-kërkesën Departamentet Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pa mjete financiare nuk kanë mundësinë që të kenë punëtor/e për mbajtjen e pikës komunale. Lidhja e Invalidëve dhe Viktimave Civile të lufte në Kosovë numëron mbi 13000 anëtarë të cilët regjistrohen si pjesë e shoqatës vetëm me vendimin që e marrin nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Beneficionet që i gëzojnë anëtarët e LIVCLK me anë të anëtarësimit përfshijnë:

1. Shërbime mjekësore pa pagesë në institucionet publike, marrëveshje kjo që respektohet dhe nuk ka ndonjë problem;
2. Lirim nga pagesa kur udhëtojnë me Trafikun Urban - por në shumicën e rasteve kjo marrëveshje nuk funksionon për shkak të mosrespektimit nga ana e punëtorëve të Trafikut Urban;
3. Lirim nga pagesa kur udhëtojnë me Hekurudhat e Kosovës, pasi që kanë pasur kërkesa të shumta nga anëtarët e LIVCLK- së se nuk po zbatohet marrëveshja në mes të Hekurudhave të Kosovës dhe udhëtarëve që kanë kartela të anëtarësisë së LIVCLK-së, kryesia e Lidhjes kanë pasur takim me Hekurudhat e Kosovës me të cilat tash kanë bashkëpunim të mirë për sa i përket lirimit nga pagesa për anëtarët e LIVCLK.
4. Lirim nga pagesa për energjinë elektrike deri në 400 kw të shpenzuara, ku përfshihen vetëm familjet e viktimave civile të luftës dhe jo invalidët civil. Marrëveshja për lirim nga pagesa për energjinë elektrike ka funksionuar për invalidët civil në kohën sa ka qenë kryeministër i Kosovës z.Agim Çeku nga viti 2006 deri në vitin 2008, pas kësaj kohe nuk ka pasur vazhdim të marrëveshjes nga KEDS – Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike.

Problemi kryesor i këtyre kategorive sipas Grabovcit janë pensionet e ulëta, e që nuk e mbulojnë as pjesën bazike për një jetë të dinjitetshme dhe krahasuar me kategoritë e tjera të dala nga lufta, si familjet e dëshmorëve, kjo kategori merr shumë më pak pension dhe mbështetje institucionale. Edhe pse kanë bërë kërkesë të vazhdueshme në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të rishqyrtojnë dhe të merren parasysh, që të paktën pensionet e kategorive civile të luftës të jenë të përafërta me ato të familjeve të dëshmorëve, nuk kanë hasur në mirëkuptim nga ana e MPMS.

Çështje tjetër të cilën e kanë ngritur si Lidhje ka qenë përqindja e ulët e pensionit që e marrin kategoritë që i përfaqësojnë, ndër të tjera edhe zgjedhja që duhet të bëjnë mes pensionit për kategorinë që i përkasin (kategoritë e dala nga lufta) apo pensionit të moshës pasi që të dyja pensionet nuk mund ti marrin njëherazi, kjo e rëndon edhe më shumë gjendjen e tyre ekonomike. Në rastin tjetër, nëse një familjar ta zëmë bashkëshorte e viktimës civile të luftës është e plagosur gjatë luftës dhe identifikohet edhe si invalid civil i luftës, ajo duhet të zgjedhë që ta marrë vetëm njërin pension dhe asesi të dy pensionet, pavarësisht faktit se u takon të dy kategorive. Gjithashtu edhe nëse një familje ka më shumë se një të vrare gjatë luftës pensionet e tyre rriten me bazë të përqindjes dhe nuk marrin pension ta zëmë për viktimën e dytë civile, gjë që është e papranueshme por nuk ka pas reagime prapë nga ana e Ministrisë.

Si pjesë e dokumenteve kryesore për anëtarësim në LIVCLK është vendimi i cili lëshohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës, në vendim nuk shkruhet emri i viktimës civile të luftës por vetëm emri i shfrytëzuesit i cili përfiton nga skema e pensionit, kjo çështje sipas Grabovcit është e gabuar pasi që duhet të ceket edhe emri i viktimës, si Lidhje kanë marrë parasysh këtë çështje dhe tash marrin informacione edhe nga shfrytëzuesit e skemës dhe i pyesin se për kënd e merrni pensionin, shembull; për bashkëshortin, për fëmijët, për prindërit.

Skema e pensioneve për kategoritë e dala nga lufta, deri në vitin 2008 ishte në njëfarë forme ose tjetër e ndërtuar 'ekskluzivisht' që të shfrytëzohej nga bashkëshortet/të vejat e këtyre kategorive. Pasi deri në këtë periudhë, vitin 2008, nuk kanë pasur të drejtë që ta shfrytëzojnë këtë pension prindërit ose anëtarët tjerë të familjes së këtyre kategorive, sidomos të viktimave civile të luftës nuk kanë pasur të drejtë për kompensim. *18 Dhjetor 2019, Prishtinë, Kosovë*

### 5.6.3 Intervistë – Ibadete Ahmeti nënë vetushqyese /bashkëshorte e viktimës civile të luftës – Prishtinë, 23 Dhjetor 2019

Ibadete Ahmeti ka qenë vetëm 23 vjeçare kur forcat serbe e kanë ndarë bashkëshortin e saj, Rexhep Ahmeti, nga kolona në fshatin Grashticë të komunës së Prishtinës pjesë e së cilës kishin qenë edhe fëmijët e tyre , vajza 3 vjeçare dhe djali 15 muajsh, me 21 Prill 1999, ku e kanë ekzekutuar dhe varrosur në varrezë masive. Deri në Korrik të vitit 1999 familja e zonjës Ahmeti nuk kishin ditur asgjë për fatin e Rexhepit, deri në hapjen e varrezës masive në fshatin Makovc, komuna e Prishtinës ku edhe kishin identifikuar kufomën e Rexhepit. Kjo fazë ishte një makth emocional i papërshkrueshëm dhe periudha më e vështirë e jetës së tyre. Pas përfundimit të luftës zonja Ahmeti u kthye të jetonte në shtëpinë e burrit, bashkë me fëmijët dhe prindërit e Rexhepit. Shtëpinë e kishte bazë të fortë të trashëgimisë së burrit dhe fatmirësisht nuk ishte prekur nga lufta, edhe pse e kishte shumë të vështirë të fillonte jetën pas tragjedisë që i kishte ndodhur, por po vazhdonte tutje vetëm për shkak të fëmijëve.

Pas regjistrimit të vdekjes së bashkëshortit nga institucionet e përkohshme të asaj kohe, ajo filloi që të merrte pensionin për familjet e kategorive të dala nga lufta, pension me shumën afro 60 EUR, e që nuk i mbulonte as nevojat bazike të fëmijëve, por po ja dilnin mbanë me pensionin e punës së vjehrrit, i cili mbulonte pjesën tjetër të nevojave si ushqimi, veshmbathje, shkollim të fëmijëve, shërbime të tjera. Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zonja Ahmeti thekson që kanë marrë dy vendime për rritje të pensionit dhe i fundit është ky me shumën që vazhdojnë ta marrin, 169 EUR. Këtë pension, zonja Ahmeti e cilëson si diskriminues edhe pse bashkë me ligjin në të cilin janë kategoritë e dala nga lufta, familjet e dëshmorëve si pjesë e saj, marrin shumë më të madhe pensioni si dhe benefite shtesë. Dihet që dëshmorët kanë kontribuar në formë të luftës së drejtpërdrejte me forcat serbe, edhe viktimat civile kanë kontribuar në forma të ndryshme në luftën e vitit 1999 dhe shkak kryesor i vrasjes së Rexhepit është fakti se forcat serbe kanë besuar që është pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Zonja Ahmeti kërkon që së paku në parim si kategori e viktimave civile të luftës të trajtohen njëjtë ose barabartë.

Përveç mbështetjes nga familja e zonjës Ahmeti, ajo pohon se nuk kanë pasur asnjë lloj mbështetje nga institucionet qeveritare, qofshin ato lokale apo qendrore. Nuk ka pasur as mbështetje psikologjike. Këtu ajo përmend lehtësimin e vetëm që e ka pasur gjatë marrjes së shërbimeve mjekësore, ku ka pasur kartelën e anëtarësisë nga shoqata që i përfaqëson kategoritë

civile të luftës. Përpos barrës së rëndë të mbajtjes së familjes si nënë vetushqyese ajo është përballur edhe me paragjykimet e rrethit në të cilin ajo jeton, duke e ngarkuar edhe më shumë gjendjen e saj emocionale e shpirtërore.

Kërkesa dhe dëshira e saj e vetme është mbështetja institucioneve në çfarëdo forme qoftë ajo, për t'i ndihmuar fëmijët e saj që të kenë një jetë të dinjitetshme dhe të mos ndjehen të anashkaluar. Si formë e ndihmës do të ishte lehtësimi në punësim apo mbështetje në hapjen e bizneseve të reja.

#### 5.6.4 Intervistë - Xhevrije Buzuku nënë vetushqyese/bashkëshorte e viktimave civile të luftës, Hallaç i Vogël-Lipjan, 27 Dhjetor 2019

Zonja Buzuku kishte parë tmerrin e vërtetë, kur para syve të saj forcat serbe kishin vrarë bashkëshortin e saj, Zeqir Buzuku dhe vajzën e saj Nadire Buzuku në mëngjesin e 19 Prillit të vitit 1999. Vajza e saj kishte qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ku ishte regjistruar si vullnetare por që ishte kthyer në shtëpi si shkak i mungesës së armëve, vetëm pak ditë para vrasjes nga forcat serbe.

Zonja Buzuku në atë kohë kishte mbetur e vetme me 4 djemtë dhe 2 vajzat. Ishin kthyer në shtëpinë e shkatërruar nga lufta dhe me kushte shumë të rënda ekonomike, mezi po ia dilnin të mbijetonin. Me rregullimin e dokumentacionit të nevojshëm për vdekjen e bashkëshortit dhe vajzës, ajo filloi të merrte pensionin për kategoritë e dala nga lufta dhe atë vetëm për bashkëshortin kurse për vajzën jo, deri para 2 viteve, ku ajo merr në total afër 200 EUR pension për të dytë, e që nuk është aspak e drejtë shprehet ajo. Për vajzën ajo ka parashtruar kërkesë që ti njihet e drejta e pensionit për familjet e dëshmorëve pasi që ka qenë e regjistruar si ushtarë e UÇK-së por ka dështuar pasi që i kanë thënë se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për këtë çështje.

Në vitin 2002 një shoqatë bamirëse ndërton shtëpinë e re të zonjës Buzuku, si ndihmë e vetme që ajo ka marrë, si pjesë e kategorive të viktimave civile të luftës.

Ajo thekson se ekzistojnë dallime shumë të mëdha në mes të kategorive të luftës e që nuk do të duhej të ishte e tillë, për shkak se kategoria e viktimave civile kanë më shumë nevojë për mbështetje sepse në parim kanë pasur kushte më të rënda dhe familje më të mëdha për të cilat është dashur të perkujdesje shtesë. Ajo shton se fëmijët e saj nuk kanë marrë asnjë lloj mbështetje nga institucionet dhe se ja kanë dalë mbanë me punën e tyre.

Mbështetje psikologjike kanë marrë nga shoqatat internacionale që kanë operuar në Kosovën e pasluftës dhe se ka qenë shumë e nevojshme, me vetë faktin se ka parë tmerrin me sytë e saj dhe se i kishin rekomanduar që të vazhdonte tutje trajtimin por që nuk e kishte bërë, për shkak të kushteve ekonomike të rënda.



### 5.6.5 Intervistë – Vezire Shala nënë vetushqyese/bashkëshorte e viktimës civile të luftës – Banjë-Malishevë, 29 Dhjetor 2019

Vezire Shala është nënë vetushqyese e kategorisë së viktimave civile të luftës, ajo ishte 47 vjeçare kur forcat serbe ia vranë bashkëshortin, Bislim Ramadan Shala, në Bellanicë të komunës së Malishevës, me 4 Prill 1999. Zonja Shala është nënë e 6 fëmijëve, 2 djemve dhe 4 vajzave, fëmiju më i madh ishte djali 27 vjeçar kurse e më e vogla vajza 6 vjeçare, në kohën kur forcat serbe ia vranë bashkëshortin. Ajo e merr pensionin për kategoritë e dala nga lufta, qysh nga koha e UNMIK-ut, por së fundmi ajo u detyrua të bëjë zgjedhje në mes të pensionit të moshës dhe atij për kategorinë e viktimave civile të luftës, ku zgjodhi të dytin për shkak të burokracive ekzistuese. Zonja Shala pohon se nuk kanë pasur asnjë lloj mbështetje institucionale, por ia ka dalë mbanë e vetme bashkë me fëmijët e saj. Ajo tregon edhe për faktin se si djali i saj i madh ka qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe i plagosur gjatë luftës por nuk ka marrë asnjëherë pension nga skemat e kategorive të dala nga lufta, pasi që nuk ka dashur. Fatmirësisht fëmijët e zonjës Shala kanë qenë më të rritur në moshë sesa pjesa tjetër e të intervistuarave, kështu që kanë hapur biznese private dhe në këtë formë kanë ndihmuar familjen. Zonja Shala pohon se pensioni nuk do të ishte i mjaftueshëm as për nevojat e saj elementare, nëse nuk do të kishte mbështetjen e fëmijëve të saj. Ajo pohon se nuk kanë pasur asnjë lloj mbështetje nga komuna e Malishevës apo nga institucione të tjera, qoftë edhe nga shoqatat dhe nuk ka qenë në dijeni se ekziston një shoqatë e cila i përfaqëson të drejtat e saj si kategori civile e luftës. Zonja Shala na tregon edhe për pjesën se si në vitet e para të pasluftës asaj iu është ofruar mbështetje psikologjike disa herë pasi që e ka parë me sytë e saj vrasjen dhe torturimin e bashkëshortit të saj nga forcat serbe , por që kjo ndihmë iu është ndaluar së ofruari në vitet pasuese.

#### **5.6.6 Intervistë – Miradije Ramadani nënë vetushqyese/bashkëshorte e viktimës civile të luftës, Krushë e Madhe-Rahovec, 30 Dhjetor 2019**

Miradije Ramadani ka qenë e martuar për 22 vite me bashkëshortin e saj Osman Ramadani, arsimtar i Gjuhës Shqipe në shkollën fillore të Krushes së Madhe, ata kanë 7 fëmijë – 6 vajza dhe 1 djalë. Vajza e madhe kishte 18 vite kurse djali i vogël vetëm 7 muaj, në kohën kur forcat serbe e morën kryefamiljarin dhe e ndanë nga familja, të cilin më pas e plagosën dhe e dogjën për së gjalli së bashku me 61 bashkëfshatar të Krushës, totali humbjeve njerëzore në këtë fshat është 130 civil - të vrarë, masakruar, djegur. Për 6 vite me radhë pasluftës zonja Ramadani nuk ka pasur asnjë informatë për vendndodhjen e trupit të bashkëshortit edhe pse ka parë videon e ekzekutimit të tij dhe e ka identifikuar në bazë të rrobave që i ka pas veshur dhe sipas dëshmitarëve ai ka qenë në grupin e fshatarëve të djegur nga forcat serbe. Në vitin 2006 i ka ardhur arkivoli me disa pjesë të trupit të bashkëshortit dhe e kanë varrosur, në varrezat e fshatit.

Fillimisht nuk ka mundur ta marrë pensionin për shkak se nuk ka pasur dëshmi për vdekjen e burrit edhe pse kanë insistuar që ajo ta pranojë faktin që është i vdekur edhe pa pasur ndonjë dëshmi për vdekje.

Zonja Ramadani gjatë luftës kishte qëndruar me djalin e sëmurë në spitalin e Gjakovës dhe më pas ishte transferuar në Kukës-Shqipëri, kurse nuk e kishte ditur që vajzat e saj po qëndronin në Durrës-Shqipëri dhe ishte ndër të parat që u kthye në fshat menjëherë pas përfundimit të luftës, mes frikës për bomba dhe mina të montuara në shtëpinë tashmë të shkatërruar por që fatmirësisht nuk iu ndodhi asgjë. Filloi jetën e vetme me fëmijët dhe ndihmën e dy shtetasve amerikan që ishin vendosur në fshat e të cilët ndihmonin me ushqime dhe veshmbathje. Deri në fazën ku e ndihmuan me një gollon (pajisje bujqësore për punimin e tokës), pastaj kur filluan të merren me bujqësi dhe fushë të hapur, aty kishin fitime për shkak të kualitetit të produkteve që i shitnin në treg. Me paratë e fituara zonja Ramadani shkolloi të gjitha vajzat, në universitet në Prishtinë, edhe pse kishte presion nga rrethi i gjerë familjar që të mos i lejonte vajzat që të shkonin e të shkolloheshin në Prishtinë. Me po të njëjtat të ardhura nga prodhimtaria bujqësore, 6 vite pas luftës, ajo ndërtoi edhe shtëpinë e re e vetme dhe pa ndihmën e askujt. Pastaj u rrit kërkesa për prodhimet bujqësore të zonjës Ramadani dhe ajo vendosi të hap firmën e saj në vitin 2017 me 13 punëtorë, biznesi i saj kultivon kryesisht produkte si; specat, domate, lakër, me të cilat prodhon

pastaj hajvar, specia turshi e fafarona, prodhime të cilat kryesisht i eksporton në Gjermani. Mbështetje e vetme nga komuna e Rahovecit ka qenë një grant me një shumë prej 2000 EUR kur e ka hapur firmën dhe asgjë më shumë. Të gjitha vajzat i ka shkolluar me punën në bujqësi dhe nuk kanë pasur ndonjë lehtësim kur janë pranuar në fakultet apo në punë.

Përveç pensionit që e merr si bashkëshorte e viktimës civile të luftës asaj i takon edhe pensioni i bashkëshortit për kontributin që ai ka dhënë në arsim për 20 vite, por që nuk e ka marrë asnjëherë për shkak se shumën (70EUR) që e marrin, ajo e quan fyese dhe aspak relevante duke marrë parasysh që bashkëshorti i saj për 10 vite ka punuar pa asnjë lloj kompensimi për shkak të situatës politike në vend asokohe.

Gjithashtu ajo cilëson se shuma e pensionit që e merr për bashkëshortin si viktimë civile e luftës është i padrejtë krahasuar me veteranët dhe familjet e dëshmorëve për shkak se është disproporcional mes kategorive dhe kërkon që së paku kjo shumë të jetë 200 EUR e që fëmijët e martirëve ta dinë që nuk ka humbur gjaku i prindërve të tyre që dhanë jetën për lirinë e Kosovës.

Një tjetër fenomen që ka ndodhur në Krushën e Madhe është se asnjë nënë nuk është larguar nga fëmijët e tyre, kanë vazhduar të qëndrojnë me fëmijët e tyre edhe nëse shembull kanë pasur vetëm një vajzë si trashëgimtare.

### 5.6.7 Intervistë – Fevzije Gërxhaliu nënë vetushqyese/bashkëshorte e viktimës civile të luftës, Studime e Poshtme –Vushtrri, 3 Janar 2020

Bashkëshorti i zonjës Gerxhaliu, Kadri Hasan Gërxhaliu, u vra nga forcat serbe, me 2 Maj 1999, bashkë me 115 shqiptarë tjerë të fshatit Studime të komunës së Vushtrrisë. Ajo ishte 35 vjeçare në atë kohë, me të ishin edhe tre fëmijët e saj të vegjël, 2 vajzat dhe djali. Jeta pa bashkëshortin ishte tepër e vështirë dhe tani mbi supe mbante barrën e të qenit nënë dhe baba për fëmijët e saj. Pensionin për kategoritë e dala nga lufta e merr që nga fillimi dhe mezi ia del e vetme pasi që shumica e pensionit nuk ishte e mjaftueshme për rritjen e fëmijëve. Zonja Gërxhaliu punon si zyrtare në Kuvendin Komunal të Mitrovicës. Ajo shprehet se për dallim nga familjet e dëshmorëve të cilët kanë kontribuar në luftë si ushtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, edhe familjet e viktimave civile kanë kontribuar në forma të ndryshme, përfshirë këtu; strehimin, furnizimin me ushqim si dhe mjekimin e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por prapë se prapë nuk kanë pasur dëshmi për të treguar kontributin e tyre. Bashkëshorti i zonjës Gërxhaliu, kishte ndihmuar UÇK-në në bartje të materialit për luftë, njëjtë edhe kunati i saj që është gjithashtu viktimë civile, kishte ndihmuar në forma të ndryshme mjekësore pasi që ishte mjek.

Zonja Gërxhaliu thotë se nuk ka pasur asnjë lloj ndihme, përveç atyre në fillim të pasluftës që i kanë marrë e gjithë popullata, si pako ushqimore e higjienike.

Fëmijët e zonjës Gërxhaliu, nuk kanë pasur mbështetje për tu regjistruar në universitet, as nuk kanë marrë ndonjë lloj burse si fëmijë të viktimës civile, për shkak se siç shprehet ajo, nuk kanë pasur nevojë sepse të gjitha i kanë arritur me punën dhe mundin e tyre.

Dy vajzat e saj janë magjistre të diplomuara dhe janë të papuna, njëjtë edhe djali i saj i cili është në përfundim të studimeve në nivelin Master. Kërkesa e saj e vetme është që të paktën institucionet të intervenojnë e të iu ndihmojnë fëmijëve të saj në punësim pasi që kjo duket të jetë ndihma e vetme që do ta marrin nga to.

#### 5.6.8 Intervistë – Nasibe Lluhani nënë vetushqyese/bashkëshorte e viktimave civile të luftës – Gjakovë, 4 Janar 2020

Historia e zonjës Nasibe Lluhani fillon me marrjen me dhunë të bashkëshortit të saj, Tefik Lluhani, nga forcat serbe me 7 Maj 1999. Tre ditë më vonë, 10 Maj 1999, po të njëjta forca marrin edhe djalin e saj Dritan Lluhani dhe i dërgojnë në drejtim të panjohur për t'i ekzekutuar. Bashkë me ta forcat serbe marrin edhe 3 vëllezërit e zonjës Lluhani, ku nuk dihet asgjë për fatin e tyre deri me 12 Qershor të vitit 2004. Aty bëhet identifikimi i kufomave të Tefikut dhe Dritanit.

Pas gjetjes së trupave të familjarëve të saj, burrit dhe djalit, ajo fillon të marrë pensionin për kategoritë e viktimave civile të luftës, si bashkëshorte e viktimës civile, por nuk merr asnjë lloj kompensimi për humbjen e djalit. Deri para 2 ose 3 viteve ajo fillon të marrë një përqindje të caktuar edhe për humbjen e djalit me afro 30 EUR më shumë nga pensioni bazë i bashkëshortit, shumë të cilën ajo e konsideron si nënçmim dhe injorim nga ana e institucioneve. Zonja Lluhani tash është 67 vjeçare dhe do të duhej t'i takonte edhe pensioni i moshës, por që nuk e merr për shkak se është dashur të zgjedh në mes të pensionit të moshës ose atij të kategorive të dala nga lufta.

Gjatë periudhës së luftës përpos humbjeve njerëzore që kishte pësuar zonja Lluhani, ajo kishte pësuar edhe shkatërrimin e plotë të shtëpisë së saj në Gjakovë dhe për ndërtimin sipërfaqësor të shtëpisë kishin ndihmuar organizatat ndërkombëtare që kishin vepruar asokohe në Kosovë, kurse për pjesën tjetër e kanë ndihmuar vetëm familja e saj. Lehtësimin e vetëm të cilin ajo e merr nga institucionet është lirimi nga pagesa e 500 kw brenda vitit për energjinë elektrike që ajo e shpenzon.

Zonja Lluhani pohon se ekziston diferencë e madhe në mes të familjeve të viktimave civile të luftës dhe familjeve të dëshmorëve që i bën të pabarabartë, po që shton se edhe nëse duan të ndryshojnë diçka në lidhje me këtë çështje nuk kanë se ku të ankohen.

Sa i përket mbështetjes psikologjike, ajo tregon se kanë pasur mbështetje vetëm në fillim të pasluftës, kryesisht nga Kryqi i Kuq, por që më vonë janë ndërprerë.

*Sqarim – Të gjitha intervistat e realizuara me nënat vetushqyese/bashkëshortet e viktimave civile të luftës në Kosovë janë përshtatur. Disa prej të intervistuarave nuk kanë pranuar që bisedat e tyre të incizohen përmes audio-incizimit por vetëm me anë të shënimeve të marra gjatë intervistimit. Kam kryer edhe një intervistë me një nënë vetushqyese të viktimës civile por që më vonë më ka kërkuar që të mos e publikoj dhe si e tillë nuk është publikuar. Të gjitha intervistat janë realizuar në terren.*

## 6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke u mbështetur në analizën e rishqyrtimit të literaturës dhe punës në terren, vijmë në përgjigjet për pyetjet hulumtuese të këtij punimi:

1. Pozita e nënave vetushqyese/ të vejave të viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë nga viti 1999 deri 2019 ka qenë e lidhur kryekëput me situatën ekonomike të tyre, fillimisht kjo kategori ka përfituar kompensime materiale të cilat nuk kanë qenë të mjaftueshme as për nevojat elementare të familjes, pasi që shumica e këtyre nënave kanë mbetur me fëmijë të vegjël. Shumica e tyre nuk kanë vendosur që të martohen prapë, pasi kanë vendosur të qëndrojnë në familjet e bashkëshortëve të tyre dhe t'i rrisin fëmijët e tyre. Barra e dyfishtë prindërore ka qenë roli i tyre kryesor. Shtuar këtu edhe barrën e përkujdesjes për prindërit e bashkëshortëve apo prindërit e vet, pasi që do të kishte paragjykime nëse ato do të jetonin të vetme me fëmijët. Rindërtimi i shtëpive të shkatërruara nga lufta ka qenë problem shtesë, në rast të shtëpia e tyre ka qenë e shkatërruar. Pastaj, shkollimi i fëmijëve ka qenë sfidë e veçante pasi nuk kanë pasur asnjë lloj ndihme nga institucionet shtetërore që në njëfarë forme do t'ua lehtësonte të paktën pjesën e shkollimit. Shumica e këtyre nënave kanë qenë shtëpiake dhe me mungesë shkollimi, gjë që e ka bërë edhe më të vështirë punësimin e tyre. Me fjalë të tjera, kjo kategori ka kaluar 20 vite që nga paslufta me sakrifica të formave të ndryshme, që kryesisht konsistojnë me gjendjen e tyre ekonomike, diskriminimin nga institucionet shtetërore duke hasur në dallime thelbësore me kategoritë tjera të dala nga lufta, por mbi të gjitha dallime mes kategorisë së viktimave civile dhe asaj të familjeve të dëshmorëve. Drejtësia për krimet e luftës mbi popullatën civile në Kosovë është çështje të cilën vazhdimisht e ngrisin edhe të intervistuarat e këtij punimi, asnjëra nga nënat vetushqyese/bashkëshortet e viktimave civile të luftës nuk ka gjetur drejtësi mbi vrasjet e bashkëshortëve të tyre nga forcat serbe.

2. Dallimet mes të vejave/bashkëshorteve të viktimave civile dhe atyre të dëshmorëve ekzistojnë, për shkak të trajtimit që u bëhet këtyre dy kategorive me bazë në ligjet ekzistuese në Kosovë të cilat mbulojnë kategoritë e dala nga lufta, mbështetur edhe nga të gjeturat nga terreni. Lartësia e shumës së pensionit që marrin këto dy kategori ka dallime të mëdha, ku familjet e dëshmorëve marrin shumë më të lartë sesa familjet e viktimave civile. Kompensimet materiale nuk janë i vetmi dallim, këtu po përfshijmë edhe të drejtat e in-kind subsisties të cilat përfshijnë

lehtësime të formave, si në shërbime shëndetësore, tatim, energji elektrike. Familjet e dëshmorëve përpos këtyre të drejtave përfitojnë edhe beneficione të tjera shtesë, kurse familjet e viktimave civile jo.

Kurse për testimin e hipotezave, nga të dhënat e mbledhura nga puna në terren vërtetojmë se hipoteza e parë është e saktë : *H1. Sa më e munguar të jetë mos-mbështetja ekonomike dhe psiko-sociale nga institucionet shtetërore për këtë kategori, aq më e vështirë do të jetë pozita e tyre në shoqëri.* Kjo pasi pozita e tyre në shoqëri tashmë është e vështirë, por mungesa e mbështetjes ekonomike dhe psiko-sociale nga institucionet shtetërore për këtë kategori e rëndon edhe më shumë gjendjen e tyre në përgjithësi.

Hipoteza e dytë: *H2. Deri sa nuk rregullohet legjislacioni edhe për nënat vetushqyese/të vejat e viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë, do të ketë dallime me kategorinë e dëshmorëve.* është e saktë pasi që legjislacioni ekzistues për kategoritë e dala nga lufta shpërfaq dallime mes dy kategorive, tek lartësia e pensioneve dhe të drejtat tjera të parapara me ligjin nr.04/L-054.

Nevojat kryesore të nënave (bashkëshorteve) vetushqyese të viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë lidhen drejtpërsëdrejti me faktorin ekonomik, ku numër i konsiderueshëm i këtyre grave janë të papuna, tash 20 vite pas luftës problemi i papunësisë bie edhe mbi fëmijët e tyre. Avancimi profesional dhe mbështetja në punësim do ti lehtësonte kësaj kategorie rritjen ekonomike.

Anash nuk mbetet as faktori psiko-social që është pjesë e përditshmërisë së tyre. Mbështetja psikologjike dhe këshillimi nga institucionet shëndetësore do tu ndihmonte shumë atyre që të ndiheshin si pjesë e papërbuzur e shoqërisë kosovare, por mbi të gjitha ajo çfarë nënat vetushqyese të viktimave civile të luftës kërkojnë është respekti.

Rishqyrtimi i statusit të familjeve të viktimave civile të luftës dhe ndryshimi i nocionit ‘viktimë civile e luftës’ në ‘martir të luftës’.



Përkrahje institucionale sidomos nga drejtoratet komunale në vendet ku kjo pjesë e shoqërisë është numerikisht më e prekur duke krijuar fonde të veçanta për nevojat themelore të nënave vetushqyese të viktimave civile të luftës.

Komponente të rëndësishme të drejtësisë tranzicionale, të tilla si duke kërkuar të vërtetën, ndjekjet, dëmshpërblimet dhe reformat institucionale, por është po aq e rëndësishme që të gjithë mekanizmat janë të dizajnuara në atë mënyrë që të marrin parasysh nevojat e veçanta për sigurimin e të drejtave të grave. Gratë kishin në përgjithësi një rol të ndryshëm se sa burrat në konflikt dhe ato ishin të prekura shpesh në një mënyrë të ndryshme prej burrave.

Kjo duhet të kuptohet dhe të merret parasysh kur të merren masa në drejtësinë tranzicionale. Çfarëdo mekanizma që janë përcaktuar mbi drejtësinë tranzicionale, ato duhet të përpiqen të sigurojnë të drejtat e grave.

Ka shumë për të mësuar për qeverinë e Kosovës nga rasti i Bosnjës, si dhe akterët e tjerë se si do të ndërtohet një sistem gjithëpërfshirës, ku do të përfshihej edhe mbështetja psiko-sociale, kujdesi shëndetësor, dhe rehabilitimi ekonomik.

Siguria ekonomike e bashkëshorteve, nënave vetushqyese të viktimave civile të luftës është e lidhur me nderin dhe dinjitetin. Shuma minimale që ato marrin si ndihmë nuk mbulon as nevojat themelore të tyre e lëre më të fëmijëve të tyre, sidomos kur familjet e tyre janë të mëdha.

Në këto raste ato shpesh kërkojnë ndihmë nga të afërmit dhe familjarët, gjë që ka pasojat psiko-sociale të ndërlydhura me barrën e turpit dhe drojës. Lufta për mbijetesë duket më e vështirë se sa lufta me armikun.

Sakrificat që kanë bërë këto nëna fillimisht për fëmijët e tyre pastaj për rrethin shoqërore është e pashpagueshme. Humbja fizike e bashkëshortëve të tyre i ka detyruar ato që për fëmijët e tyre të jenë edhe baba edhe nënë për ta, e mbi të gjitha ruajtja e nderit dhe moralit në mentalitetin e brishtë kosovar ka qenë pikësynimi kryesor. Shumica e këtyre grave jetojnë së bashku me prindërit apo vjehrrit e tyre dhe kujdesen për ta në forma të ndryshme, përfshirë këtu edhe mbulimin e shpenzimeve mjekësore të tyre.

Nevojat shëndetësore të nënave vetushqyese të viktimave civile të luftës lidhen ngushtë me stresin në mjedisin ku ato jetojnë, gjë që rezulton edhe në sëmundje të ndryshme. Siç është cekur edhe më lartë familjarët e viktimave civile të luftës gëzojnë kujdesin shëndetësor parësor dhe dytësor, problematike shfaqet për këtë kategori edhe njohja e kësaj të drejtë nga ana e mjekëve pasi shpesh nuk ua pranojnë apo njohin kartelat e anëtarësisë.

Familjarët e dëshmorëve të UÇK-së gëzojnë edhe kujdesin shëndetësorë terciar. Këtu shfaqen edhe disfavorizimet dhe pakënaqësitë ndërmjet këtyre dy kategorive të luftës. Tash 20 vite nga lufta e vitit '99, arritjet jetësore dhe e ardhmja e fëmijëve të tyre janë shpresa dhe motivi kryesorë për jetë i këtyre nënave.

## 7.1 Propozimet për politikat sociale në Kosovë – Nën timeret vetushqyese të viktimave civile të luftës:

Riintegrimeri i nënave vetushqyese në jetën ekonomike, duke u dhënë atyre hapësirë për punë, por edhe nxitjen e hapjes së bizneseve të reja që do tu mundësonin këtyre nënave vetëpunësim.

Përkujdesje shëndetësore cilësore dhe pa dallime, kryesisht trajtime të veçanta të shëndetit mendor në rast të krizave psikike dhe ankthit për këtë kategori si dhe ofrimin e programeve rehabilituese me bazë në komunitet.

Të iu mundësohet që të paktën kategoritë e dala nga lufta të mos diskriminohen kur duhet të zgjedhin mes pensionit që ato duan të marrin, shembull: kur nënave vetushqyese të kategorisë së viktimave civile duhet të zgjedhin mes pensionit të moshës apo atij të viktimës civile, por të marrin të dy pensionet sepse është e drejtë e tyre pasi që i përmbushin kriteret për të dyja.

Gjithashtu nëse kanë më shumë se një anëtarë të familjes si viktime civile të luftës, shembull: bashkëshortin dhe fëmijën, të mos marrin vetëm përqindjen, 20% në këtë rast, por të kenë të drejtë ti marrin shumën për dy pensione te plota për kategorinë e viktimave civile.

Rishqyrtimin e statusit të familjeve të viktimave civile. Aktualisht, sistemi i pabarabartë i përfitimeve u jep familjeve të viktimave civile më pak ndihmë financiare sesa atyre të UÇK-së apo familjeve të dëshmorëve . Njohja publike e gjendjes së rëndë ekonomike me të cilën përballen shumë familje nënkupton edhe ofrimin e mbështetjes financiare të ngjashme me atë që i ofrohen familjeve të ushtarëve të UÇK-së të vrarë në betejë.

## REFERENCAT

Annette Weber. (2006). Feminist Peace and Conflict Theory. *Routledge Encyclopaedia on Peace and Conflict Theory* , 1-11.

Baker, C. &-W. (2016). Mapping the Nexus of Transitional Justice and Peacebuilding. *Journal of Intervention and Statebuilding* , 281-301.

Ball&Kruger. (2015, January). *liberkujtimiikosoves.org*. Retrieved December 1, 2019, from [http://www.liberkujtimiikosoves.org/wp-content/uploads/2015/01/Patrick\\_Ball\\_and\\_Jule\\_Kruger-Evaluation\\_of\\_the\\_Database\\_KMB.pdf](http://www.liberkujtimiikosoves.org/wp-content/uploads/2015/01/Patrick_Ball_and_Jule_Kruger-Evaluation_of_the_Database_KMB.pdf): [http://www.liberkujtimiikosoves.org/wp-content/uploads/2015/01/Patrick\\_Ball\\_and\\_Jule\\_Kruger-Evaluation\\_of\\_the\\_Database\\_KMB.pdf](http://www.liberkujtimiikosoves.org/wp-content/uploads/2015/01/Patrick_Ball_and_Jule_Kruger-Evaluation_of_the_Database_KMB.pdf)

FDHK. (2015, February 4). [http://www.kosovomemorybook.org/wp-content/uploads/2015/02/Prezantimi\\_dhe\\_evaluimi\\_i\\_bazes\\_se\\_te\\_dhenave\\_te\\_Liber\\_Kujtimit\\_te\\_Kosove\\_Prishtine\\_04\\_02\\_2015.pdf](http://www.kosovomemorybook.org/wp-content/uploads/2015/02/Prezantimi_dhe_evaluimi_i_bazes_se_te_dhenave_te_Liber_Kujtimit_te_Kosove_Prishtine_04_02_2015.pdf). Retrieved December 3, 2019, from [http://www.kosovomemorybook.org/wp-content/uploads/2015/02/Prezantimi\\_dhe\\_evaluimi\\_i\\_bazes\\_se\\_te\\_dhenave\\_te\\_Liber\\_Kujtimit\\_te\\_Kosove\\_Prishtine\\_04\\_02\\_2015.pdf](http://www.kosovomemorybook.org/wp-content/uploads/2015/02/Prezantimi_dhe_evaluimi_i_bazes_se_te_dhenave_te_Liber_Kujtimit_te_Kosove_Prishtine_04_02_2015.pdf): [http://www.kosovomemorybook.org/wp-content/uploads/2015/02/Prezantimi\\_dhe\\_evaluimi\\_i\\_bazes\\_se\\_te\\_dhenave\\_te\\_Liber\\_Kujtimit\\_te\\_Kosove\\_Prishtine\\_04\\_02\\_2015.pdf](http://www.kosovomemorybook.org/wp-content/uploads/2015/02/Prezantimi_dhe_evaluimi_i_bazes_se_te_dhenave_te_Liber_Kujtimit_te_Kosove_Prishtine_04_02_2015.pdf)

HRONEŠOVÁ, J. (2018). BONES AND RECOGNITION: COMPENSATING FAMILIES OF MISSING PERSONS IN POST-WAR BOSNIA AND HERCEGOVINA. *JOURNAL OF PEACEBUILDING & DEVELOPMENT* , 47-49.

Kosoves, K. i. (2011, December 8). *kuvendikosoves.org*. Retrieved May 10, 2019, from [kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org): <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20statusin%20e%20deshmoreve.pdf>

Matthews, R. (2010). Metodatat e Hulumtimit. In M. Ross, *Metodat e Hulumtimit, Udhezues praktik per shkencat sociale dhe humane* (pp. 152-173). Tirane: Qendra per Arsim Demokratik (CDE).

Mustafa, A. (2017). Welfare Politics in Kosovo: Growing Role for the State and Benefit Disproportionality. *Eastern European Social Policy Network* , 23-43.

Ticknner, Sjoberg. (2010). Feminizmi, Kreu 10. In K. S. Dunne, *Teori e Marredhenieve Nderkombetare* (pp. 244-245). Tirane: UET Press.

UNMIKONLINE.ORG. (2000, December 21). Retrieved May 10, 2019, from UNMIK Gazette: [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000\\_66.htm](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_66.htm)

LIGJI Nr. 04/L-054 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E DËSHMORËVE, INVALIDËVE, VETERANËVE, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, VIKTIMAVE CIVILE DHE FAMILJEVE TË TYRE

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2793> (Retrieved December 5,2019)

LIGJI NR. 04/L-172 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-054 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E DËSHMORËVE, INVALIDËVE, VETERANËVE, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, VIKTIMAVE TË DHUNËS SEKSUALE TË LUFTËS, VIKTIMAVE CIVILE DHE FAMILJARËVE TË TYRE

<https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/ligji-nr-04-l-172-per-ndrysh-plot-e-ligjit-nr-04-l-054-per-vik-sek-pdf/> (Retrieved December 2,2019)

Zyra e Kryeministrit, Zyra për çështje të kategorive të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

<http://kryeministri-ks.net/zyra-e-kryeministrit/zyrat/zyra-per-ceshtje-te-kategorive-te-dala-nga-lufta-e-ushtrise-clirimtare-te-kosoves/> (Retrieved November 20,2019)

Vlerësimi i nevojave të viktimave në Kosovë / përpiluar nga CaitlinMcCurn, Rudina Hasimja ; përkthyer nga Arbër Shtëmbari, DraganaMilutinović - Prishtinë : QHDP, 2012. (Retrieved September 20,2019).

\*Sqarim mbi të dhënat e nga Fondi për të Drejtën Humanitare - Për përdorimin e të dhënave nga Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Documentation Center Kosovo kam biseduar personalisht me personelin dhe më kanë lejuar që të përdor të dhënat e tyre nga databaza Kosovo Memory Book.

## BIBLIOGRAFIA

Cynthia Enloe *Maneuvers: the international politics of militarizing women's lives*, Berkeley, CA: University of California Press.(2000)

Doris Buss *Performing Legal Order: Some Feminist Thoughts on International Criminal Law* *International Criminal Law Review* 11 (2011)

*Women Nation State* ed Nira Yuval Davis and Floya Anthias Macmillan press LTD (1989)

Biljana Kasic *The dynamic of Identification within Nationalist Discourse, From Gender to Nation* ed Rada Ivekovic and Julie Mostov. 2002 A Longo Editore 8 Julie Mostov, *Politics of national identity in the former Yugoslavia* ed Tamar Mayer *Gender Ironies of Nationalism Sexising the Nation* Routledge 2000

Tamar Mayer *Gender Ironies of Nationalism Sexising the Nation* Routledge 2000

Office of the High Commissioner for Human Rights, *Healing the Spirit; Reparation for Survivors of Sexualized Violence Related to the Conflict in Kosovo*

The United Nations Office of the High Commissioner for Human Rights (OHCHR) subsequently developed a guide on Rule-of-Law Tools for Post-Conflict States: Reparations Program, which provide practical guidance on how to render operative the Basic Principles.

"Feminism and Peace." *Hypatia* 9, no. 2 (1994).

"Women and War." *Peace Review* 8, no. 3 (1996, September).

Arendt, Hannah. *The Human Condition*. Chicago: University of Chicago Press, 1958.

Beauvoir, Simone de. *The Second Sex*. N.Y.: Random House, 1974.

Benhabib, Seyla. *Situating the Self: Gender Community and Postmodernism in Contemporary Ethics*. Cambridge: Polity Press, 1992.

Bennett, Olivia, Jo Bexley, and Kitty Warnock, eds. *Arms to Fight – Arms to Protect*. London: Panos, 1995.

- Butler, Judith. *Gender Trouble: Feminism and the Subversion of Identity*. N.Y.; London: Routledge, 1990.
- Chandra Talpade Mohanty, Ann Russo, and Lourdes Torres, eds. *Third World Women and the Politics of Feminism*. Bloomington: Indiana University Press, 1991.
- Chapkins, Wendy, ed. *Loaded Questions: Women in the Military*. Amsterdam: Transnational Institute, 1981.
- Chodorow, Nancy. *The Reproduction of Mothering: Psychoanalysis and the Sociology of Gender*. Berkeley, Los Angeles: University of California Press, 1978.
- Cooke, Miriam. "Wo-Man, Retelling the War Myth." In *Gendering War Talk*, edited by Miriam Cooke and Angela Woollacott, 177-204. New Jersey: Princeton University Press, 1993.
- Cooke, Miriam, and Angela Woollacott, eds. *Gendering War Talk*. NJ: Princeton University Press, 1993.
- Dietz, Mary. "Citizenship with a Feminist Face: The Problem with Maternal Thinking." *Political Theory* 13, no. 1 (1985).
- DiStefano, Christine. *A Feminist Perspective on Modern Political Theory*. Ithaca: Cornell University Press, 1991.
- Ehrenreich, Barbara. *Blood Rites. Origins and History of the Passions of War*. New York: Metropolitan Books, 1997.
- Eifler, Christine, and Ruth Seifert, eds. *Soziale Konstruktionen - Militär Und Geschlechterverhältnis., Forum Frauenforschung*. Münster: Westfälisches Dampfboot, 1999.
- 34.Elshtain, Jean Bethke. *Women and War*. Chicago: University of Chicago Press, 1987.
- Grant, Rebecca. "The Quagmire of Gender and International Security." In *Gendered States. Feminist (Re) Visions of International Relations Theory.*, edited by Spike Peterson. Boulder; London: Lynne Rienner, 1992.

Gray, Chris Hables. *Postmodern War: The New Politics of Conflict*. New York: Guilford Press, 1997.

Ivekovic´, Rada. "Nationalism and War as They Affect Women." In *Krieg/War. Eine Philosophische Auseinandersetzung Aus Feministischer Sicht.*, edited by Wiener Philosophinnen Club. München: Wilhelm Fink Verlag, 1997.